

GJYKATA SUPREME KOSOVËS

Gjykata Supreme e Kosovës
Ap.-Kz. Nr. 527/2012
Prishtinë
11 dhjetor 2012

Gjykata Supreme e Kosovës ka mbajtur seancën e kolegjit sipas nenit 26, par. (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), dhe nenit 15.4 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve për gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it në Kosovë (Ligji mbi kompetencat), më datën 20 nëntor 2012 në objektin e Gjykatës Supreme në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger në cilësinë e kryetarit të kolegjit dhe gjyqtarët e EULEX-it Martti Harsia dhe Horst Proetel dhe gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Kosovës Valdete Daka dhe Emine Mustafa si anëtare të kolegjit, të asistuar nga zyrtari ligjor Holger Engelmann në rolin e procesmbajtësit,

Në praninë e:

Prokurores publike të EULEX-it Judith Eva Tatraj nga Zyra e Prokurorisë së Shtetit të Kosovës (ZPSHK)


Avokatëve mbrojtës:

- Av. F. G. B. për të pandehurin A. K.
- Av. R. K. për të pandehurin B. L.
- Av. H. M. për të pandehurin R. M.
- Av. M. S. për të pandehurin S. SH.
- Av. D. R. për të pandehurin S. S.
- Av. Q. Z. për të pandehurin B. S.

Në lëndën penale me numër AP.-KŽ. 527/2012 kundër të pandehurve:

A. K. [Redacted]

B. L. [Redacted]



R. M. [REDACTED]

S. SH. [REDACTED]

S. S. [REDACTED]

B. S. [REDACTED]

Në përputhje me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në lëndën P. Nr. 425 / 2011, të datës 30 mars 2012, të regjistruar në shkrimoren e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës të njëjtën ditë, të pandehurit ishin liruar nga akuzat në vijim me të cilat ishin ngarkuar përmes aktakuzës PPS Nr. 07 / 2010, të datës 25 korrik 2011:

1. A. K. [REDACTED]:

Pika 1: Krim i luftës kundër popullatës civile dhe krim i luftës kundër robërve të luftës, sipas neneve 142, 144 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP të RSFJ-së), po ashtu të parapara në nenet 120 dhe 121 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), lidhur me nenet 22, 24, 26 të KP RSFJ-së duke shkelur nenin e përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe nenet 4, 5 (1) të Protokollit plotësues II të katër Konventave të Gjenevës (AP II); i akuzuari, në cilësinë e pjesëtarit të UÇK-së në bashkëkryerje me të akuzuarit F. L. N. KR. N. K. N. S. B. I. B. S. SH. [REDACTED] dëshmitarin bashkëpunues 'X', të akuzuarin S. S. [REDACTED] dhe me ushtarë të tjerë të UÇK-së deri më tani të paidentifikuar, ka cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të pacaktuar të civilëve serbë dhe shqiptarë si dhe të të burgosurve ushtarakë serbë, të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë duke i mbajtur ata në kushte çnjerëzore (duke përfshirë këtu lidhjen e të burgosurve me zinxhir, objektet e papërshtatshme, të ftohtit e tepërt, mungesën e kushteve sanitare, ushqimin joadekuat, rrahjet e shpeshta); në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, prej pjesës së hershme të vitit 1999 deri kah mesi i qershorit të vitit 1999;

- Pika 2: Krim i luftës kundër robërve të luftës sipas neneve 22, 142 të KP RSFJ-së, aktualisht të sanksionuar në bazë të neneve 23, 120 të KPK-së, duke shkelur nenin e përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe nenet 4, 5 (1) të (AP II); i akuzuari, në cilësinë e pjesëtarit të UÇK-së, në bashkëkryerje me të akuzuarit N [REDACTED] K [REDACTED] N [REDACTED] S [REDACTED], R [REDACTED] M [REDACTED], N [REDACTED] KR [REDACTED] dhe dëshmitarin bashkëpunues 'X' ka marrë pjesë në vrasjen e një të burgosuri ushtarak serb, i paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, mbetjet mortore të të cilit janë gjetur në një varrezë masive afër Kleçkës ku ishin pesë trupa të pajetë, më saktë i pandehuri ka marrë pjesë në krim duke ia ofruar një kosë N [REDACTED] S [REDACTED] kryerësit të drejtpërdrejtë të vrasjes, edhe pse e dinte, sepse ishte i njoftuar shprehimisht për qëllimin e N [REDACTED] S [REDACTED] për ta vrarë të burgosurin me atë kosë në Kleçkë, komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar të muajit prill të vitit 1999, jo më herët se para datës 11 prill 1999;
- Pika 3: Krim i luftës kundër robërve të luftës, sipas neneve 22, 144 të KP të RSFJ-së, aktualisht të sanksionuar në bazë të neneve 23, 120 të KPK-së, duke shkelur nenin e përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe nenet 4, 5 (1) të AP II; i akuzuari, në cilësinë e pjesëtarit të UÇK-së dhe në bashkëkryerje me të akuzuarit F [REDACTED] L [REDACTED] N [REDACTED] K [REDACTED], N [REDACTED] S [REDACTED], N [REDACTED] KR [REDACTED], B [REDACTED] L [REDACTED] dhe me dëshmitarin bashkëpunues 'X', ka marrë pjesë në vrasjen e N [REDACTED] D [REDACTED] dhe V [REDACTED] M [REDACTED], dy policë serbë, të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, të cilët janë ekzekutuar nga dëshmitari bashkëpunues 'X' me disa plumba të shkrepur nga revolja; më saktësisht, i pandehuri ka marrë pjesë në krim duke i mbajtur viktimat në dispozicion të kryerësit të drejtpërdrejtë të ekzekutimit, edhe pse i njëjti e dinte (sepse ishte shprehimisht i njoftuar rreth urdhrin të drejtpërdrejtë të F [REDACTED] L [REDACTED]), ose së paku ka mundur ta parasheh lehtë nga urdhrat e marrë (marshimi i dy të burgosurve në një vend të largët në pyll) se çfarë do tu ndodhte atyre; në një lokacion të njohur si Livadhi i Canit afër Kleçkës, Lipjan, më ose rreth datës 04/05 prill 1999;

2. B [REDACTED] L [REDACTED]:

- Pika 1: Krime të luftës kundër popullsisë civile dhe krime të luftës kundër robërve të luftës, nga nenet 22, 142, 144 të KP RSFJ-së, tani të dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në kundërshtim të nenit të përbashkët 3 të katër konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe të neneve 4, 5(1) APII, i akuzuari, në cilësinë e pjesëtarit të UÇK-së, në bashkëkryerje me F [REDACTED] L [REDACTED], N [REDACTED] KR [REDACTED], N [REDACTED] K [REDACTED], N [REDACTED] S [REDACTED], A [REDACTED] K [REDACTED], B [REDACTED] S [REDACTED], S [REDACTED] SH [REDACTED], dëshmitarin bashkëpunues 'X', S [REDACTED] S [REDACTED], dhe me ushtarë të tjerë të UÇK-së ende të paidentifikuar, ka cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të pacaktuar të civilëve serbë dhe shqiptarë si dhe të të burgosurve ushtarakë serbë, të mbajtur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, duke i mbajtur në kushte çnjerëzore (duke përfshirë lidhjen e të burgosurve me zinxhirë, objektet e papërshtatshme, të ftohtit e tepërt, mungesën e kushteve sanitare, ushqimin joadekuat, rrahjet e shpeshta); në Kleçkë,

komuna e Lipjanit, prej fillimit të vitit 1999 deri nga mesi i qershorit të vitit 1999;

Pika 2: Krime të luftës kundër robërve të luftës, nga nenet 22, 144 të KP RSFJ-së, tani të dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në kundërshtim të nenit të përbashkët 3 të katër konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe të neneve 4, 5(1) APII, i akuzuari, në cilësinë e pjesëtarit të UÇK-së, në bashkëkryerje me F [redacted] L [redacted] N [redacted] K [redacted] N [redacted] S [redacted] N [redacted] KR [redacted] A [redacted] K [redacted] dhe dëshmitarin bashkëpunues 'X', ka marrë pjesë në vrasjen e dy policëve serbë N [redacted] D [redacted] dhe V [redacted] M [redacted], të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, të cilët janë ekzekutuar nga dëshmitari bashkëpunues 'X' me disa plumba të shkrepur nga revolja; më saktësisht, i pandehuri ka marrë pjesë në krim duke i marshuar të dy të burgosurit deri te pika e ekzekutimit dhe duke i mbajtur viktimat në dispozicionin e kryerësit të drejtpërdrejtë të ekzekutimit, edhe pse ai e dinte, (sepse ishte shprehimisht i njoftuar për urdhrin e F [redacted] L [redacted]), ose së paku ai mund lehtë ta parashihte nga urdhrat e pranuar (marshimi i dy të burgosurve serbë deri te një vend i largët në pyll) se çfarë do t'u ndodhte atyre; në vendin e quajtur Livadhi i Canit afër Kleçkës, komuna e Lipjanit, më ose rreth datës 4/5 prill, 1999;

3. R [redacted] M [redacted]:

Pika 1: Krime të luftës kundër popullsisë civile dhe krime të luftës kundër robërve të luftës, nga nenet 22, 142, 144 të KP RSFJ-së, tani të dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në kundërshtim të nenit të përbashkët 3 të katër konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe të neneve 4, 5(1) APII, i akuzuari, në cilësinë e pjesëtarit të UÇK-së, në bashkëkryerje me N [redacted] KR [redacted], N [redacted] K [redacted] dhe N [redacted] S [redacted] kanë vrarë A [redacted] A [redacted], shqiptar kosovar i cili më herët ishte i paraburgosur pastaj i liruar nga qendra e paraburgimit në Kleçkë; më saktësisht, i pandehuri ka marrë pjesë në krim duke e mbajtur viktimën në dispozicion të kryerësve dhe duke e shtyrë në një vrimë në tokë ku si pasojë është ekzekutuar nga N [redacted] KR [redacted] dhe N [redacted] K [redacted] me armë të zjarrit AK - 47; në Kleçkë, komuna e Lipjanit, prej fillimit të vitit 1999 deri nga mesi i qershorit të vitit 1999;

Pika 2: Krime të luftës kundër robërve të luftës, nga nenet 22, 142, 144 të KP RSFJ-së, tani të dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në kundërshtim të nenit të përbashkët 3 të katër konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe të neneve 4, 5(1) APII, i akuzuari, në cilësinë e pjesëtarit të UÇK-së, në bashkëkryerje me, N [redacted] KR [redacted] N [redacted] S [redacted] N [redacted] K [redacted], A [redacted] K [redacted] dhe dëshmitarin bashkëpunues 'X', ka marrë pjesë në vrasjen e të burgosurit ushtarak serb; më saktësisht i pandehuri ka marrë pjesë në krim duke e marshuar të burgosurin deri te pika e ekzekutimit dhe duke e mbajtur atë në dispozicionin e kryerësit të drejtpërdrejtë të ekzekutimit N [redacted] S [redacted], edhe pse ai e dinte, sepse ishte shprehimisht i njoftuar rreth qëllimit të

N [REDACTED] S [REDACTED] për ta vrarë të burgosurin nga biseda e mëparshme në mes këtij të fundit me F [REDACTED] L [REDACTED], se i burgosuri do të ekzekutohej; in Kleçkë, komuna e Lipjanit, në datë të pacaktuar në prill 1999, jo para 11 prillit 1999;

4. S [REDACTED] SH [REDACTED]

- Pika 1: Krime të luftës kundër popullsisë civile dhe krime të luftës kundër robërve të luftës, nga nenet 22, 142, 144 të KP RSFJ-së, tani të dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në kundërshtim të nenit të përbashkët 3 të katër konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe të neneve 4, 5(1) APII, i akuzuari, në cilësinë e pjesëtarit të UÇK-së, në bashkëkryerje me F [REDACTED] L [REDACTED] N [REDACTED] KR [REDACTED] N [REDACTED] K [REDACTED] N [REDACTED] S [REDACTED] A [REDACTED] K [REDACTED] B [REDACTED] L [REDACTED], B [REDACTED] S [REDACTED] dëshmitarin bashkëpunues 'X', S [REDACTED] S [REDACTED] dhe me ushtarë të tjerë të UÇK-së ende të paidentifikuar ka cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të pacaktuar të civilëve serbë dhe shqiptarë si dhe të të burgosurve ushtarakë serbë, të mbajtur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, duke i mbajtur në kushte çnjerëzore (duke përfshirë lidhjen e të burgosurve me zinxhirë, objektet e papërshtatshme, të ftohtit e tepërt, mungesën e kushteve sanitare, ushqimin joadekuat, rrahjet e shpeshta); në Kleçkë, komuna e Lipjanit, prej fillimit të vitit 1999 deri kah mesi i qershorit të vitit 1999;
- Pika 2: Krime të luftës kundër robërve të luftës, nga nenet 22, 144 të KP RSFJ-së, tani të dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në kundërshtim të nenit të përbashkët 3 të katër konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe të neneve 4, 5(1) APII, i akuzuari, në cilësinë e pjesëtarit të UÇK-së, në bashkëkryerje me dëshmitarin bashkëpunues 'X', N [REDACTED] K [REDACTED], N [REDACTED] S [REDACTED], B [REDACTED] S [REDACTED] torturuan katër ushtarakë të burgosur serbë, të mbajtur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, mbetjet mortore të të cilëve janë gjetur në një varrezë masive pranë Kleçkës, nga të cilët së paku tre janë identifikuar përmes analizës së ADN-së si B [REDACTED] C [REDACTED] Z [REDACTED] F [REDACTED] dhe Z [REDACTED] T [REDACTED] duke i rrahur në vazhdimësi; në Kleçkë, komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar të muajit prill 1999, jo më herët se më 11 prill 1999;

5. S [REDACTED] S [REDACTED]

- Pika 1: Krime të luftës kundër popullsisë civile dhe krime të luftës kundër robërve të luftës, nga nenet 22, 142, 144 të KP RSFJ-së, tani të dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në kundërshtim të nenit të përbashkët 3 të katër konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe të neneve 4, 5(1) APII, i akuzuari, në cilësinë e pjesëtarit të UÇK-së, në bashkëkryerje me F [REDACTED] L [REDACTED] N [REDACTED] K [REDACTED], N [REDACTED] K [REDACTED] N [REDACTED] S [REDACTED] A [REDACTED] K [REDACTED], B [REDACTED] L [REDACTED], B [REDACTED] S [REDACTED] S [REDACTED] SH [REDACTED] dëshmitarin bashkëpunues 'X' dhe me ushtarë të tjerë të UÇK-

së ende të pidentifikuar, ka cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të pacaktuar të civilëve serbë dhe shqiptarë si dhe të të burgosurve ushtarakë serbë, të mbajtur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, duke i mbajtur në kushte çnjerëzore (duke përfshirë lidhjen e të burgosurve me zinxhirë, objektet e papërshtatshme, të ftohtit e tepërt, mungesën e kushteve sanitare, ushqimin joadekuat, rrahjet e shpeshta); në Kleçkë, komuna e Lipjanit, prej fillimit të vitit 1999 deri kah mesi i qershorit të vitit 1999;

6. B S:

Pika 1: Krime të luftës kundër popullsisë civile dhe krime të luftës kundër robërve të luftës, nga nenet 22, 142, 144 të KP RSFJ-së, tani të dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në kundërshtim të nenit të përbashkët 3 të katër konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe të neneve 4, 5(1) APII, i akuzuari, në cilësinë e pjesëtarit të UÇK-së, në bashkëkryerje me F L N KR N K N S A K B L S SH dëshmitarin bashkëpunues 'X' dhe S S dhe me ushtarë të tjerë të UÇK-së ende të pidentifikuar, ka cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të pacaktuar të civilëve serbë dhe shqiptarë si dhe të të burgosurve ushtarakë serbë, të mbajtur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, duke i mbajtur në kushte çnjerëzore (duke përfshirë lidhjen e të burgosurve me zinxhirë, objektet e papërshtatshme, të ftohtit e tepërt, mungesën e kushteve sanitare, ushqimin joadekuat, rrahjet e shpeshta); në Kleçkë, komuna e Lipjanit, prej fillimit të vitit 1999 deri kah mesi i qershorit të vitit 1999;

Pika 2: Krime të luftës kundër robërve të luftës, nga nenet 22, 144 të KP RSFJ-së, tani të dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në kundërshtim të nenit të përbashkët 3 të katër konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe të neneve 4, 5(1) APII, i akuzuari, në cilësinë e pjesëtarit të UÇK-së, në bashkëkryerje me dëshmitarin bashkëpunues 'X', N K, N S dhe S SH torturuan katër ushtarakë të burgosur serbë, të mbajtur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, mbetjet mortore të cilëve janë gjetur në një varrezë masive afër Kleçkës, nga të cilët së paku tre janë identifikuar përmes analizës së ADN-së si B C, Z F dhe Z T, duke i rrahur në vazhdimësi; në Kleçkë, komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar të muajit prill 1999, jo më herët se më 11 prill 1999;

Aktgjykim i gjykatës së shkallës së parë ishte bazuar në mënyrë vendimtare mbi faktin se në shpalljen e shqyrtimit gjyqësor të datës 21 mars 2012, kolegji kishte nxjerrë Aktvendimin mbi pranueshmërinë e deklarimeve dhe të ditarëve të A Z të cilët kishte shpallur krejtësisht të papranueshme.

Prokurori Special i Republikës së Kosovës (PSRK) brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë më datën 17 korrik 2012 kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, duke apeluar në të njëjtën kohë edhe ndaj aktvendimit mbi pranimin e deklarimeve dhe ditarëve të A [REDACTED] Z [REDACTED] të datës 21 mars 2012, të nxjerrë nga po e njëjta gjykatë. Është konstatuar se ky aktgjykim përmbante shkelje të shumta esenciale të procedurës penale si dhe e kishte të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të gabueshme dhe jo të plotë.

Ishte propozuar si më poshtë:

1. Të anulohet "Aktvendimi mbi pranueshmërinë e deklarimeve dhe të ditarëve të A [REDACTED] Z [REDACTED], i cili ishte nxjerrë gjatë seancës gjyqësore të datës 21 mars 2012";
2. Të shpallehin si të pranueshme të gjitha deklaratimet dhe ditarët e përmendur në "Aktvendimin mbi pranueshmërinë e deklarimeve dhe të ditarëve të A [REDACTED] Z [REDACTED], të cilët ishin shpallur të papranueshme;
3. Rrjedhimisht, të anulohet në tërësi aktgjykimi i datës 30 mars 2012 kundër të pandehurve N [REDACTED] KR [REDACTED], N [REDACTED] K [REDACTED] F [REDACTED] I [REDACTED] dhe N [REDACTED] S [REDACTED];
4. Të kthehet lënda në rigjykim para një trupi tjetër gjyqësor;
5. Për çdo rast, të anulohet aktgjykimi i datës 30 mars 2012 në pjesën me të cilën shpallehin të papranueshme provat e konfiskuara në banesat e F [REDACTED] L [REDACTED] dhe të N [REDACTED] KR [REDACTED];
6. Të shpallehin si të pranueshme provat e konfiskuara në banesat e F [REDACTED] L [REDACTED] dhe të N [REDACTED] KR [REDACTED];

Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSHK), në përgjigjen e tyre të datës 4 tetor 2012 ka mbështetur në mënyrë të plotë ankesën e PSRK-së.

Duke u mbështetur në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në lëndën P. Nr. 425 / 2011, të datës 2 maj 2012 (të regjistruar në shkrimoren e së njëjtës gjykatë në të njëjtën ditë), në ankesën me shkrim të dorëzuar nga PSRK-ja, në opinionin e paraqitur të ZPSHK-së, në përgjigjet e mbrojtjes, në të dhënat përkatëse të shkresave të lëndës dhe në parashtrësit verbale të palëve gjatë seancës dëgjimore të datës 11 dhjetor 2012, pas një analize të ligjit në fuqi, Gjykata Supreme e Kosovës, pas mbajtjes së këshillimit më datën 11 dhjetor 2012, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

Ankesa e parashtruar më 18 korrik 2012 nga Prokurori Special i Republikës së Kosovës kundër Aktgjykimit P. Nr. 425/2011 të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, të datës 30 mars 2011, PRANOHET.

1. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës P. Nr. 425/2011, i datës 30 mars 2012, së bashku me "Aktvendimin mbi pranueshmërinë e deklarimeve dhe të ditarëve të A [REDACTED] Z [REDACTED], të nxjerrë gjatë seancës së

shqyrtimit gjyqësor të datës 21 mars 2012 ANULOHEN. Deklarimet dhe ditarët e përmendur në këtë aktvendim SHPALLEN TË PRANUESHME.

2. Lënda KTHEHET NË RIGJYKIM DHE VENDOSJE.

3. Provat e sekuestruara gjatë bastisjes së hapësirave në objektet e N
KR dhe F L SHPALLEN TË PRANUESHME.



Tabela e përmbajtjes

ARSYETIMI

HISTORIA E PROCEDURËS

.....
8

GJETJET E GJYKATËS

.....
11

A. Çështjet e Pranueshmërisë

.....
11

**I. KOMPETENCA E GJYKATËS SUPREME PËR TË
VENDOSUR MBI ANKESËN E PSRK-së KUNDËR
AKTVENDIMIT TË GJYKATËS SË QARKUT 'MBI
PRANUESHMËRINË E DEKLARIMEVE DHE DITARËVE TË
A Z DHE ANKESËN ME KOHË TË
PROKURORIT TË PSRK-së**

.....
11

**II. PËRJASHTIMI I SUPOZUAR I ZYRTARIT LIGJOR TË
PROKURORIT TË PSRK-së NË SEANCËN E GJYKATËS
SUPREME TË DATËS 20 NËNTOR 2012**

.....
11

B. Shkeljet substanciale të dispozitave të procedurës penale

.....
12


**I. SHKJELJA E PRETENDUAR E NENIT 156 PARAGRAFIT 2
TË KPPK-së**

.....
12

**1. Përdorimi jo i drejtë i pretenduar i nenit 156 paragrafit 2
të KPPK-së nga PSRK-ja**

.....
13

**2. Standardet ligjore të 'mundësisë për të kundërshtuar' siç
kërkohet me nenin 156 paragrafin 2 të KPPK-së**



.....
14

3. Zbulimi i mjaftueshëm i provave për mbrojtjen gjatë marrjes në pyetje të A [REDACTED] Z [REDACTED] në mes 05 dhe 09 korrikut 2012

.....
17

4. Pretendimi mbi 'fushën' e pamjaftueshme të dëgjimit të A [REDACTED] Z [REDACTED] në mes 05 dhe 09 korrikut 2011

.....
21

- II. PAPANUESHMËRIA E PRETENDUAR E DËSHMIVE TË A [REDACTED] Z [REDACTED] PËR SHKAK TË PARALAJMËRIMIT TË GABUAR

.....
22

- III. PAPANUESHMËRIA E PRETENDUAR E DEKLARATAVE TË A [REDACTED] Z [REDACTED] PËR SHKAK TË MUNGESËS SË NËNSHKRIMIT SIÇ KËRKOHET ME LIGJ

.....
27

- IV. PAPANUESHMËRIA E PRETENDUAR E 'DITARËVE TË LUFTËS' TË A [REDACTED] Z [REDACTED]

.....
28

- C. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

.....
29

- I. VLERËSIMI I PROVAVE I GJYKATËS SË QARKUT PËRTEJ ÇËSHTJES SË PRANUESHMËRISË SË DEKLARIMEVE TË A [REDACTED] Z [REDACTED]

.....
29

- II. PAPANUESHMËRIA E PRETENDUAR E DËSHMIVE PËR SHKAK TË URDRIT TË PAMJAFTUESHËM PËR BASTISJE


.....
30

- D. Kolegji i ndryshëm i rigjykimit

.....
32

E. Përmbledhja

.....
34



III

ARSYETIMI

Historia e procedurës

1. Pasi që i ndjeri A. Z. (i njohur gjatë fazës së mëvonshme të gjyqimit edhe si 'dëshmitari X'), në mënyrë vullnetare kishte ardhur në Njësitin hetimor për Krime të Luftës të policisë së EULEX-it dhe kishte deklaruar para saj në cilësinë e dëshmitarit në datat 20 dhe 30 nëntor pastaj edhe më 3 dhjetor 2009, policisë iu bë me dije për herë të parë gjithçka që A. Z. ishte gati për t'iu treguar. Si rezultat i hetimeve fillestare policore në këtë kontekst, u nisën hetimet ndaj të ndjerit A. Z. i njohur gjatë fazës së mëvonshme të gjyqimit edhe si 'dëshmitari X') dhe atë përmes aktvendimit të PSRK-së PPS. 07 / 2010, të datës 2 shkurt 2010, dhe janë zgjeruar më 16 shkurt 2010 edhe për një pikë shtesë.
2. Me anë të aktvendimit të PSRK-së PPS. 07 / 2010, të datës 5 korrik 2010, këto hetime u zgjeruan edhe kundër të pandehurve S. H., H. H., U. G., S., S., F., I., M. (ndaj të cilit hetimi kishte përfunduar më 25/10 2010) dhe N. KR.
3. Me anë të aktvendimit të PSRK-së PPS. 07 / 2010, të datës 27 tetor 2010, të nxjerrë më 5 nëntor 2010, janë nisur hetimet kundër të pandehurve B. S., A. K., B. L., N. K., X. K., N. S., H. S., S. SH. dhe S. T.
4. Me anë të aktvendimit të PSRK-së PPS. 07 / 2010, të datës 27 tetor 2010, të nxjerrë më 10 nëntor 2010, hetimet kanë filluar edhe kundër të pandehurit R. M.
5. Me anë të aktvendimit të PSRK-së PPS. 07 / 2010, të datës 27 tetor 2010, të nxjerrë më 15 nëntor 2010, hetimet janë zgjeruar edhe kundër të pandehurve B. S., A. K., B. L., N. K., X. K., N. S., H. S., S. SH. dhe S. T. si dhe R. M.
6. Me anë të aktvendimit të PSRK-së PPS. 07 / 2010, të datës 1 shkurt 2011 hetimet janë zgjeruar edhe kundër të pandehurit S. S., ndërsa përmes aktvendimit tjetër të PSRK-së të datës së njëjtë, hetimet janë zgjeruar edhe kundër të pandehurve të tjerë B. S., A. K., N. S., S. SH. dhe N. K.
7. Më 04, 09, 11, 16, 17 shkurt, 15, 16, 25 mars 09 qershor dhe 20 gusht 2010 Prokurori i PSRK-së ka marrë në pyetje A. Z. (alias dëshmitari 'X') në cilësinë e të pandehurit.
8. Më 5 korrik 2010, Prokurori i PSRK-së ka paraqitur kërkesë pranë gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë për t'i dhënë A. Z. (i njohur si dëshmitari 'X') statusin e dëshmitarit bashkëpunues;

9. Më 25 gusht 2010, gjyqtari i procedurës paraprake ka aprovuar statusin e dëshmitarit bashkëpunues për dëshmitarin 'X' dhe ka vendosur që deklaratat e tij të jenë të mbyllura sipas Nenit 299 paragrafëve 2 dhe 3 të KPPK-së.
10. Më 05 dhe 07 korrik 2011, Prokurori i PSRK-së ka marrë në pyetje A [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] si dëshmitar bashkëpunues 'X'.
11. Me letrën e datës 27 korrik 2011 Prokurori i PSRK-së ka ftuar të gjithë avokatët mbrojtës që të marrin në pyetje dëshmitarin bashkëpunues 'X' alias A [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] në sallën e prokurorisë më 05, 06, 07, dhe 09 korrik 2011 dhe t'i sjellin pyetjet e tyre. Në përgatitjen e këtyre intervistave, në veçanti, Dosja A e PSRK-së e cila përmbante deklaratat e A [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] të dhëna para Prokurorit të PSRK-së të datës 4, 9, 11, 16 dhe 17 shkurt 2010, më 10, 16 dhe 25 mars 2010, më 6 qershor, 20 gusht 2010, 5 dhe 7 tetor 2010, me deklaratat relevante të policisë dhe bashkëngjitjet e tjera dhe Dosja B e PSRK-së e cila përmbante procesverbale të ndryshme të Policisë së EULEX-it dhe PSRK-së nga seanca dëgjimore të shumë dëshmitarëve të tjerë dhe bashkëngjitje të shumta i janë zbuluar mbrojtjes në përgatitje të seancave të caktuara të marrjes në pyetje. Për më tepër, në mes të 11 majit dhe 07 korrikut 2011, të gjitha raportet e zvarrosjes në lidhje me Kleçkën siç përmbahen në dosjet I dhe L të PSRK-së si dhe- më 09 korrik 2011 - kopjet e ditarit të A [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] 0096-09-EWC2/001, 002, 011, 013 dhe 014 u janë zbuluar avokatëve mbrojtës. Brenda kontekstit të afatit kohor të referuar, Prokurori nuk ka zbuluar materiale të tjera, siç përmbahen në Dosjet e PSRK-së C, D, F, H dhe M dhe KA Dosjen 1. Lista e detajuar e të gjitha materialeve të referuara është përgatitur në aktvendimin e kundërshtuar të Gjykatës së Qarkut mbi pranueshmërinë e deklaratave dhe ditarëve të A [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] të datës 21 mars 2012.
12. Më 25 korrik 2011, Prokurori i PSRK-së ka ngritur aktakuzën (PPS Nr. 07/2010) kundër të pandehurve A [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR], N [REDAKTUAR] KR [REDAKTUAR], N [REDAKTUAR] KL [REDAKTUAR], B [REDAKTUAR] L [REDAKTUAR], F [REDAKTUAR] L [REDAKTUAR], R [REDAKTUAR], M [REDAKTUAR], N [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] SH [REDAKTUAR], S [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] dhe B [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] dhe i ka akuzuar ata për pikat sikurse u renditen më lart (f. nr. 2 e këtij aktgjykimi);
13. Më 24 dhe 25 gusht 2011; gjyqtari për konfirmim në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë ka mbajtur seancat për konfirmim bazuar në aktakuzën të konfirmuar tërësisht me aktvendimin për konfirmim të datës 26 gusht 2011.
14. Më 28 shtator 2011, dëshmitari bashkëpunues 'X', A [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] është gjetur i vdekur afër vendbanimit të tij në Gjermani, pasi ai gjoja kishte bërë vetëvrasje;
15. Më 09 nëntor 2011 Prokurori i PSRK-së pjesërisht ka tërhequr aktakuzën duke e kufizuar në Pikën 2 kundër të pandehurit A [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR];
16. Shqyrtimi gjyqësor filloi me një trupi gjykues të përzier të gjyqtarëve të EULEX-it dhe Kosovës në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë përmes 18 seancave më 11 nëntor, 01 dhe 14 dhjetor 2011, 16, 30 dhe 31 janar, 06, 07, 09, 28 dhe 29 shkurt, 01, 05, 06, 07, 21 dhe 30 mars dhe 02 maj 2012.
17. Në seancën e 21 mars 2012, kolegji nxori Aktvendimin mbi pranueshmërinë e deklaratave dhe ditarëve të A [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] dhe të gjitha deklaratimet e dhëna nga tash dëshmitari i ndjerë duke përfshirë 'Ditarët e luftës' të tij, i shpalli të papranueshme.

18. Në seancën e 30 mars 2012, kolegji vendosi që akuzat kundër të pandehurve A. K. [REDAKTUAR], B. L. [REDAKTUAR], R. M. [REDAKTUAR], S. SH. [REDAKTUAR], S. [REDAKTUAR] dhe B. S. [REDAKTUAR] të ndahen dhe nxori aktgjykimin për lirimin e tyre.

19. Kundër të pandehurve në fjalë, Gjykata e Qarkut ka mbajtur edhe një seancë tjetër më 2 maj 2012 kur u shpall aktgjykimi për lirimin e tyre nga të gjitha akuzat.

20. Më 18 korrik 2012, PSRK, e cila pranoi aktgjykimin e kundërshtuar më 6 korrik 2012, ka ushtruar ankesë me kohë ndaj aktgjykimit në pajtueshmëri me Nenin 398, paragrafin 1 dhe Nenin 399, paragrafin 1 të KPPK-së ku theksoi dhe propozoi sikurse u theksua më lart.

21. ZPShK-ja po ashtu ka ushtruar ankesë ndaj aktgjykimit kundër të katër të bashkëpandehurve të parë të tjerë.

22. ZPShK ka paraqitur mendimin dhe propozimin e saj më datë 4 tetor 2012 në këtë gjykatë në të njëjtën ditë dhe plotësisht ka mbështetur pozicionet e PSRK-së.

23. Më 20 nëntor 2012 Gjykata Supreme e Kosovës ka mbajtur seancë për të vendosur mbi ankesën e PSRK-së kundër aktgjykimit me të cilin lirohen të katër të pandehurit e tjerë N. KR. [REDAKTUAR], N. K. [REDAKTUAR], F. L. [REDAKTUAR] dhe N. [REDAKTUAR]. Në ditën e njëjtë u shpall aktvendimi (Ap.-Kž. 453/2012) me të cilin ankesa pranohet pjesërisht dhe lënda kthehet në rigjykim.

24. Më 11 dhjetor 2012, Gjykata Supreme e Kosovës ka mbajtur një seancë në pajtim me Nenin 410 të KPPK-së.

Përfaqësuesi i ZPShK-së i është referuar ankesës me shkrim të PSRK-së dhe mendimit me shkrim të ZPShK-së, ka konfirmuar propozimet e tyre sikurse është shqiptuar me shkrim dhe ka propozuar të dërgoj katër të pandehurit në paraburgim. Avokatët mbrojtës po ashtu konfirmuan parashtrësit dhe propozimet e tyre me shkrim dhe njëzëri propozuan të refuzohet kërkesa e ZPShK-së për paraburgim kundër katër të pandehurve.



GJETJET E GJYKATËS

A. Çështjet e pranueshmërisë:

I. KOMPETENCA E GJYKATËS SUPREME PËR TË VENDOSUR MBI ANKESËN E PSRK-së KUNDËR AKTVENDIMIT TË GJYKATËS SË QARKUT 'MBI PRANUESHMËRINË E DEKLARATAVE DHE DITARËVE TË A. Z. DHE ANKESËN E PARAQITUR ME KOHË TË PROKURORIT TË PSRK-së

25. Avokati mbrojtës i të pandehurit N. KR. Av. F. V. në paraqitjen e tij gojore në panelin e apelit më 20 nëntor 2012 ka kundërshtuar kompetencën e Gjykatës Supreme, duke iu referuar Neneve 319 dhe 154 të KPPK-së. Ai në veçanti ka theksuar se Neni 319 paragrafi 3 i KPPK-së do të ishte shumë preciz, duke thënë se Neni 154 i KPPK-së zbatohet *mutatis mutandis* kur është në pyetje ankesa kundër aktvendimit mbi mos pranueshmërinë e provave të nxjerrë gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor. Pavarësisht se në bazë të Nenit 154 paragrafi 3 të KPPK-së afati për të ankimuar aktvendimin e tillë është i kufizuar në 48 orë nga marrja e aktvendimit, e që në lëndën në fjalë kishte kaluar kohë të gjatë më parë, kur Prokurori i PSRK-ja paraqiti ankesën e tij më 21 gusht 2012, ankesa do të duhej të vendosej nga një kolegji i procedurës paraprake të Gjykatës së Qarkut.

26. Gjykata Supreme konstaton se në lëndën në fjalë pohimet e Mbrojtjes janë pa meritë dhe prandaj të pabazuara. Neni i referuar 319 paragrafi 3 i KPPK-së shprehimisht përcakton për lëndën se *'kryetari i trupit gjykues [...]nxjerr një aktvendim të posaçëm për shpalljen e [...]provave të papranueshme, ndërsa në lëndën në fjalë 'Aktvendimi mbi pranueshmërinë e deklaratave dhe ditarëve të A. Z. i kundërshtuar i datës 21 mars 2012 është nxjerr nga i tërë trupi gjykues i shqyrtimit gjyqësor i Gjykatës së Qarkut.*

Për arsyet e theksuar më lart, afatet dhe kompetenca për ankesa kundër *'Aktvendimet që merren në lidhje me [...] mund të kundërshtohen vetëm me ankesë kundër aktgjykimit'*, sikurse përcaktohet me Nenin 431 paragrafi 3 të KPPK-së.

II. PËRJASHTIMI I SUPOZUAR I ZYRTARIT LIGJOR TË PROKURORIT TË PSRK-së NË SEANCËN E GJYKATËS SUPREME TË DATËS 20 NËNTOR 2012

27. Avokati mbrojtës i të pandehurit N. S. ka theksuar në fund të seancës së Gjykatës Supreme më 20 nëntor 2012 dhe gjatë fjalës përfundimtare vetëm atë se sipas mendimit të tij procedura nuk ka qenë korrekte, pasi që Zyrtari Ligjor i cili asistonte përfaqësuesin e ZPRK-së gjatë seancës ka asistuar para prokurorit të PSRK-së gjatë shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Qarkut dhe për më tepër ai është caktuar përgjithmonë në PSRK-së. Prandaj kryetari i kolegjit të Gjykatës Supreme është dashur të vendos për përjashtimin e Zyrtarit Ligjor në pajtim me Nenin 45 paragrafi 3 të KPPK-së.

28. Gjykata Supreme konstaton se pretendim është pa merita dhe prandaj i pabazuar. Pavarësisht se Zyrtari Ligjor i përmendur nuk ka pasur ndonjë rol aktiv gjatë zhvillimit të procedurës në Gjykatën Supreme, Neni 45 paragrafi 3 i KPPK-së shprehimisht dhe ekskluzivisht përmend procesmbajtësit, përkthyesit, specialistët dhe ekspertët si persona që ndoshta mund të largohen për shkak të përjashtimit të tyre të supozuar. *Ratio legis* e kësaj dispozite është e bazuar në faktin se personeli mbështetës dhe ekspertët dëshmitarë të përmendur atje kanë një ndikim të menjëhershëm në zhvillimin e gjykimit, përmbajtjen e të dhënave, kuptimin e duhur të përbashkët të parashtrësve për tu përkthyer për të gjitha palët dhe kështu mbi rezultatet e procedurës penale për shkak të detyrave të tyre specifike. Një situatë e tillë nuk ekziston në lidhje me një zyrtar ligjor, i cili sipas kërkesës, mund të këshillojë prokurorin për historinë e procedurës të një lënde shumë të ndërlikuar, në të cilën ai / ajo është i përfshirë thellësisht. Një zyrtar ligjor si i tillë nuk është i autorizuar për të bërë deklaratat gjatë një seance gjyqësore në emër të ndonjë pale dhe për pasojë nuk ka asnjë mundësi për të ndikuar drejtpërdrejt në procedurën e një seance gjyqësore. Statusi i tij ose i saj është i krahasueshëm me një vëzhgues apo këshilltar.

B. Shkeljet substanciale të dispozitave të procedurës penale

29. Prokurori i PSRK-së në ankesën e tij të përbashkët kundër 'Aktvendimi mbi pranueshmërinë e deklaratave dhe ditarëve të A. Z.' të datës 21 mars 2012 dhe aktgjykimit të shkallës së parë të datës 02 maj 2012 ka kundërshtuar shkeljet e Nenit 403 paragrafi 2 pika 1 të KPPK-së, sepse Gjykata e Qarkut supozohet t'i ketë interpretuar dhe zbatuar Nenet 156 paragrafin 2, 237 paragrafin 4, 238 dhe 307 të KPPK-së në mënyrë jo korrekte. Veçanërisht, kushtet e gjykatës lidhur me nivelin ligjor për t'i dhënë Mbrojtjes një 'mundësi ta kundërshtojë' në pajtim me Nenin 156 paragrafin 2 të KPPK-së do të ishin shumë të mëdha dhe në mospajtim me *ratio legis* dhe gjykimin e GJEDNj. Për më tepër vlerësimi i gjykatës sa i përket lidhjeve në mes të Nenit 156 paragrafit 2 dhe Nenit 237 paragrafit 4 të KPPK-së do të ishte i gabuar. Përveç kësaj, vlerësimi i gjykatës lidhur me paralajmërimet e bëra A. Z. në rolet e tij të ndryshme si i pandehur, dëshmitar dhe dëshmitar bashkëpunues do të ishte i papërshtatshëm dhe në mospajtim me ligjin pasi që A. Z. është paralajmëruar në mënyrë të duhur në secilën fazë të procedurës. Gjithashtu fakti që jo të gjitha faqet e deklaratave të tij me shkrim të dhëna PSRK janë nënshkruar nga A. Z. por gjithmonë vetëm faqja e fundit e secilës deklaratë, do të kishte ndikim në vlefshmërinë dhe pranueshmërinë e këtyre deklaratimeve. Për shkak të gjithë kësaj, të gjitha deklaratat e A. Z. duke përfshirë 'ditarët e luftës' të tij do të ishin provë e pranueshme dhe vlerësimet e Gjykatës së Qarkut shkelën në veçanti Nenin 403 paragrafin 2 pikën 1 të KPPK-së.

I. SHKELJE E SUPOZUAR E NENIT 156 PARAGRAFIT 2 TË KPPK-së:

30. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se nuk mundë të vërtetohet asnjë zbatim jo i duhur i Nenit 156 paragrafi 2 të KPPK-së nga ana e PSRK-së lidhur me marrjen në pyetje të A. Z. si dëshmitar bashkëpunues në mes të 05 dhe 09 korrik 2011. Gjykata Supreme nuk pajtohet me vlerësimin e Gjykatës së Qarkut lidhur me kushtet

e supozuara për dhënie të një "mundësie adekuate dhe të duhur" Mbrojtjes për të kundërshtuar deklaratimet e dëshmitarit dhe për dallim nga Gjykata e Qarkut po ashtu konstaton se jo vetëm mundësia e seancave dëgjimore nëpër të cilat A. Z. është dashur të kalojë ishte e mjaftueshme për fazën e përmendur të procedurës. Gjykata Supreme gjithashtu i konstaton të pabaza pohimet e gjykatës lidhur me keq orientimin e supozuar të prokurorit të PSRK bërë Mbrojtjes lidhur me shanset e mundshme në të ardhmen për të marrë në pyetje më tej A. Z. Gjithashtu është një përgjegjësi e rëndë e Mbrojtjes në çdo procedurë penale të studioj me kujdes lëndën, të përgatisin strategjinë e tyre mbrojtëse dhe të vlerësojnë - bazuar në përvojën e jetës - zhvillimet e mundshme në të ardhmen që mund të ndikojnë në zhvillimin e procedurës penale.

Neni i referuar 156 paragrafi 2 i KPPK-së thotë me sa vijon:

(2) Deklarimi i dëshmitarit i dhënë në polici ose para prokurorit publik mund të jetë provë e pranueshme në gjykatë vetëm kur të pandehurit ose mbrojtësit i është dhënë mundësia ta kundërshtojë atë nëpërmjet marrjes në pyetje të dëshmitarit gjatë ndonjë faze të procedurës penale.

1. Përdorimi i pavend i supozuar i Nenet 156 paragrafit 2 të KPPK-së nga ana e PSRK-së:

31. Gjykata e Qarkut është e mendimit se prokurori i PSRK-së ka bërë përdorim të pavend të Nenet 156 paragrafit 2 të KPPK-së. Neni 156 paragrafi 2 i KPPK-së nuk do të ishte "procedurë në vetë vete [...K]PPK nuk parasheh një procedurë në dispozicion të prokurorisë gjatë fazës së hetimit për të zhvilluar marrjet në pyetje të dëshmitarit sipas Nenet 156 (2) [që kjo e fundit prandaj do të ishte] një rrjet sigurie"(Aktvendimi mbi pranueshmërinë e deklaratave dhe ditarëve të A. Z. të datës 21 mars 2012, f.25 nr.47 dhe 47 në versionin e tij në anglisht). Në vend të kësaj, Prokurori Special është dashur të shfrytëzojë Nenet 237 paragrafin 4 të lexuar me Nenin 238 të KPPK-së, pra të paraqes provat para gjyqtarit të procedurës paraprake (Aktvendimi mbi pranueshmërinë e deklaratave dhe ditarëve të A. Z. të datës 21 mars 2012, f.33, nr.58, 62-63). Kjo do të përbente një kualitet të procedurës dhe marrjes në pyetje të afërt me seancat e shqyrtimit gjyqësor.

32. Gjykata Supreme kupton se prokurori i PSRK-së në njoftimin e tij bërë Mbrojtjes për seancat e marrjes në pyetje të A. Z. të datës 27 qershor 2011, në mënyrë të qartë ka përdorur gjuhën nga Neni 156 (2) të KPPK-së dhe pajtohet me vlerësimin e Gjykatës së Qarkut në masën që kjo dispozitë nuk përcakton një procedurë për mbrojtjen për marrje në pyetje. Megjithatë, krahasimi i Nenet 156 paragrafit 2 dhe Nenet 237 paragrafit 4 të KPPK-së, sikurse e bën Gjykata e Qarkut, është sikurse krahasimi në mes të mollëve dhe dardhave. Përderisa Neni 156 paragrafi 2 i KPPK-së përbën një rregull për pranueshmërinë e deklaratave të dëshmitarëve të dhëna në polici apo prokurori, Neni 237 paragrafi 4 i KPPK-së është një opsion procedural që përcakton se '[ai]prokurori publik mund të vendos ...' për marrje në pyetje të dëshmitarëve. Prandaj vlerësimi i Gjykatës së Qarkut se Neni 156 paragrafi 2 i KPPK-së është një "rrjet sigurie" nuk e plotëson karakterin e normës e as nuk ndihmon në situatën në fjalë dhe prandaj konsiderohet i pakuptim.

Edhe pse një dispozitë e duhur dhe e vlefshme për të përcaktuar një procedurë për marrjen në pyetje të dëshmitarit i cili mund të mos jetë në dispozicion gjatë shqyrtimit gjyqësor, mund të gjendet në Nenin 238 të KPPK-së, zbatueshmëria e këtij Neni në lëndën në fjalë, sikurse shtjellohet nga Gjykata e Qarkut, në 'Aktvendimin mbi pranueshmërinë e deklaratave dhe ditarëve të A. Z.' të saj, të datës 21 mars 2012, është thjesht spekulative. Dispozita, me gjuhën e saj në mënyrë të qartë ka etiketuar si një përjashtim nga rregulla, se është projektuar për 'qëllim të ruajtjes së provës kur ekziston vetëm një... rrezik potencial se kjo provë nuk do të mund të merrej gjatë shqyrtimit gjyqësor' dhe prandaj hap një mundësi të jashtëzakonshme për një dëshmitar të dëgjohet nga gjyqtari i procedurës paraprake sipas propozimit të prokurorit ose të pandehurit.

Megjithatë, në kohën në fjalë nuk kishte shenja të një '...rrezik potencial se kjo provë nuk do të mund të merrej gjatë shqyrtimit gjyqësor', sikurse përcaktohet me Nenin 238 paragrafi 1 të KPPK-së. Pasi që ky parakusht nuk është plotësuar, nuk ka pasur indikacione për PSRK-në të konsideroj zbatimin e kësaj dispozite procedurale të jashtëzakonshëm. Gjykata Supreme konstaton se në fillim të korrik 2011 kur avokatët mbrojtës janë ftuar të marrin në pyetje A. Z. në kuadër të deklarimeve të tij të mëhershme, nuk ka pasur asnjë mundësi të predikohet se ai do të kryente vetëvrasje dhe prandaj të gjendet i vdekur dy muaj e gjysmë më vonë. Për më tepër KPPK nuk përmban asgjë që ndalon procedurën e përdorur nga prokurori.

2. Standardet ligjore të 'mundësisë për të kundërshtuar' sikurse kërkohet me Nenin 156 paragrafin 2 të KPPK-së:

33. Lidhur me standardet ligjore të një 'mundësie për ta kundërshtuar' sikurse kërkohet me Nenin 156 paragrafi 2 të KPPK-së, Gjykata e Qarkut në 'Aktvendimin mbi pranueshmërinë e deklaratave dhe ditarëve të A. Z.' të saj, të datës 21 mars 2012 dhe pas atij edhe në aktgjykimin e datës 02 maj 2012, shprehjen e Ligjit e ka interpretuar të jetë një term ligjor që kërkon të plotësohet me përmbajtje nga gjyqtari. Prandaj ajo ka ngritur kushte të shumta shtesë në lidhje me pyetjen, kur një mundësi e tillë i plotëson standardet e Nenit 156 paragrafit 2 të KPPK-së. Në veçanti, Gjykata e Qarkut ka zhvilluar idenë se përmbajtja e 'mundësisë' në mes tjerash do të varet nga kompleksiteti i lëndës, statusi i dëshmitarit të mundshëm si bashkë-kryerës i supozuar në lëndë në të cilën ai / ajo është deklaruar, fakti që një dëshmitar ndoshta është dëshmitar i vetëm në dispozicion në një lëndë, që nuk mund të ketë asnjë argument vërtetues në dispozicion për pjesët vendimtare të një lënde (këtu në lidhje me identitetin e kryerësve të supozuar) dhe se - në lëndën në fjalë - dëshmitari përkatës, A. Z. ka vdekur. Prandaj, mbi bazat lëndë-pas-lënde, kushtet e 'mundësi' në pajtim me Nenin 156 paragrafi 2 të KPPK-së do të ishin fleksibile dhe me intensitet të ndryshëm. Në lëndën në fjalë, duke qenë se gjoja nuk ekziston provë vërtetuese për të gjitha aspektet e trajtuara në deklaratimet e A. Z. dhe që për më tepër ky i fundit vdiq në shtator 2011, standardet ligjore të 'mundësia' "mund të kërkohet pothuajse po aq marrje në pyetje sikurse do të ndodhte në shqyrtimin gjyqësor" ('Aktvendimi mbi pranueshmërinë e deklaratave dhe ditarëve të A. Z.', të datës 21 mars 2012 f.25 nr.47 në versionin në gjuhën angleze).

34. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se këto kushte shtesë të shtjelluara nga Gjykata e Qarkut në shumicën e tyre janë të pabaza dhe prandaj fuqishëm nuk pajtohet me to.

Nën aspektet metodologjike, Gjykata e Qarkut ka vendosur qerren drejtë për drejtë para kalit në atë se ata përpqen të rrisin kushtet e supozuara lidhur me një "fleksibilitetit të nivelit ligjor të mundësisë" për pranueshmërinë e provave, pasi që situata kritike është bërë realitet dhe dëshmitari në fjalë ka vdekur papritur. Për më tepër dhe në veçanti, pavarësisht nga fakti se shprehja 'mundësi' në Nenin 156 paragrafin 2 të KPPK-së qëndron vetëm dhe pa asnjë aditivë të tillë si "adekuat dhe i duhur" standardet shtesë të përcaktuara nga Gjykata e Qarkut në këtë drejtim konsiderohen të jenë në përputhje me disa argumente të Mbrojtjes, sipas të cilave gjykata duhet të vlerësojë besueshmërinë e provave në përcaktimin e pranueshmërisë saj. Në dallim me këtë, kushtet e 'mundësisë për ta kundërshtuar' adeguate dhe të duhura janë zhvilluar nga GJEDNJ dhe për këtë arsye do të analizohen në lidhje me aplikimin e tyre të duhur në një fazë të mëvonshme të këtij aktvendimi (shih më poshtë f.19 ff).

35. Lidhur me çfarëdo pjese të provave, në këtë kontekst duhet të theksohet, se si rregull ka një dallim të madh në mes të pranueshmërisë dhe besueshmërinë, me përmendjen e mëhershme të mënyrës në të cilën janë marrë provat, ndërsa besueshmëria përcaktim i peshës që akordohet me një pjesë të caktuar të provave në krahasim me të tjerat. Besueshmëria e një pjesë të veçantë të provave mund të vlerësohet vetëm pasi të gjitha provat të jenë paraqitur dhe në pikëpamje krahasuese me të gjitha provat e tjera. Pavarësisht diskutimeve dhe dallimeve në lidhje me disa detaje, të gjitha sistemet ligjore në Evropë në mënyrë të qartë dallojnë në mes të çështjeve të pranueshmërisë dhe çështjeve të arsyetimit të bazuar, i cili dallim vlen edhe në lidhje me vlerësimin e provave. Përderisa çështja e pranueshmërisë së provave zakonisht bëhet relevante pothuajse në një fazë mjaft të hershme të procedurave, të tilla si në fazën e konfirmimit dhe mund të ri-shqyrtohen nga trupi gjykues i shqyrtimit gjyqësor më vonë, çështja e mbështetshmërisë shkon së bashku me çështjen e besueshmërisë së një dëshmitari dhe duhet të ngritet në një fazë shumë të mëvonshme, zakonisht në fund të shqyrtimit gjyqësor, pasi të gjitha provat e pranueshme të jenë prezantuar dhe vlerësuar në lidhje me të gjitha provat e tjera në lëndë siç kërkohet me Nenin 387 paragrafi 2 të KPPK-së. Si pasojë, pjesë të provave të pranueshme të një lënde gjyqësore mund të konsiderohen jo të besueshme në fund të vlerësimit të provave dhe kështu të ketë një ndikim individuale në rezultatet e lëndës. Megjithatë, çështja e besueshmërisë nuk mund të konsiderohet si një kusht për pranueshmërinë e provave.

Vetëm në raste ekstreme mund të dalë si një përjashtim se çështjet e pranueshmërisë dhe besueshmërinë bien së bashku. Kjo mund të shërbejë si një shembull që një deklaratë është marrë me forcë, kërcënim apo një mjet të ngjashëm të ndaluar; deklarata do të konsiderohet në mënyrë të qenësishme jo e besueshme nga përkufizimi dhe për këtë arsye e papranueshme sipas Nenit 161 paragrafit 4 të KPPK-së.

Në lëndën në fjalë, Gjykata Supreme nuk mundë të vërtetojë ndonjë arsye qo do të arrinte në nivelin e papranueshmërisë dhe jo besueshmërisë të përbashkët. Çështja nëse ka apo nuk ka mospërputhje serioze në deklaratimet e A. Z. pohimet se ndoshta shënime të caktuar të datarit nga 2004 është e mundur të jenë shkruara nga të tjerë njerëz përveç atij, se A. Z. ka një histori të shëndetit mendor, se duket që A. Z. tërhoqi deklaratat e tij në një letër që u zbulua pas vdekjes së tij, ose që, sipas ish-bashkëshortes së tij G. T. disa nga deklaratat e tij janë bërë nën

presion – sikurse është ngritur nga Mbrojtja – në të vërtetë mund të lënë hapësirë për diskutim dhe vlerësim të kujdesshëm të provave. Kjo megjithatë nuk rezulton automatikisht në papranueshmërinë e asaj prove.

Prandaj, në mënyrë të veçantë, pyetja, nëse ka apo nuk ka ndonjë provë konfirmimi në dispozicion për të mbështetur deklaratat në fjalë të A. Z., nuk ka asnjë ndikim mbi pranueshmërinë e deklaratave si të tilla. Për më tepër, statusi i dëshmitarit si bashkë-kryerës i supozuar dhe në lidhje me pohimet e caktuara, i vetmi dëshmitar në dispozicion mund të jetë me interes për gjykatën kur është fjala për çështjen e mbështetshmërisë dhe besueshmërisë. Megjithatë, kjo nuk ka ndikim të menjëhershëm në nivelin ligjor të 'mundësisë për ta kundërshtuar'. Gjithashtu fakti që dëshmitari ka vdekur nuk mund të ketë asnjë rëndësi për 'mundësi për ta kundërshtuar', pasi ky është një fakt që në mënyrë të pamundur do të mund të ishte i njohur paraprakisht nga ndonjë nga palët, duke përfshirë prokurorin e PSRK-së. (Në lidhje me këtë të fundit, përsëri është theksuar se ky është kuptimi i qartë i Nenit 156 paragrafit 2 të KPPK-së, për të siguruar njohjen e dëshmitarit, i cili në një fazë të mëvonshme mund të mos jetë më në dispozicion).

36. Duhet të theksohet se Neni 156 paragrafi 2 i KPPK-së nuk kërkon aspak marrjen në pyetje – as bazuar në formulimin e tij, e as që rezulton nga interpretimi në përputhje me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (këtej e tutje: KEDNJ).

Neni 6 paragrafi 3 pika d e KEDNJ-së si standard minimal kërkon që secili i akuzuar për një vepër penale ka "të drejtën për të marrë ose të ketë të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij...".

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ) përcakton:

'...në rrethana të caktuara, mund të jetë e nevojshme, t'u referohemi depozitimeve të bëra gjatë fazës hetimore (në veçanti, ku një dëshmitari refuzon të përsëris depozitimin e tij në publik për shkak të frikës për sigurinë e tij, një dukuri jo e rrallë në gjykimet lidhur me organizatat e llojit - Mafia). Nëse të pandehurit i është dhënë mundësia adekuate dhe e duhur për të kundërshtuar depozitimet, ose të bëra ose që do të bëhen në një fazë të mëvonshme, pranimi i tyre në prova nuk do të ishte në vetvete në kundërshtim të Nenit 6 § § 1 dhe 3 (d).'¹

Në këtë drejtim KEDNJ nuk ka vendosur një standard më të lartë sesa ai i parashikuar nga dispozitat e ligjit vendor.

37. Për të gjitha këto arsye të mësipërme, "fleksibiliteti i nivelit ligjor të mundësisë", i kërkuar sikurse është shpallur nga Gjykata e Qarkut nuk mund të qëndrojë, pasi Gjykata në këtë mënyrë krijon standarde, të cilat nuk mund të maten në mënyrë të besueshme, të sigurt dhe autentike.

¹ Në *Lucà v. Itali*, Kërkesë nr. 33354/96), 27 shkurt 2001 par. 40; po ashtu në *Melnikov v. Rusi*, para. 65, Kërkesë nr. 23610/03, 14 janar 2010 dhe tash së voni *Hümmer v. Gjermani*, Kërkesë nr. 26171/07, 19 korrik 2012/para. 38 ff.

3. Mjaftueshmëria e zbulimit të provave për Mbrojtjen gjatë marrjeve në pyetje të A. Z. në mes të 05 dhe 09 korrikut 2012:

38. Gjykata e Qarkut, për më tepër, ka bërë referencë në gjykimin e caktuar të GjEDNj dhe kërkon që *'mundësia për ta kundërshtuar'* të jetë patjetër, *"adekuate dhe e duhur"*, që do të thotë se *"ajo duhet të jetë reale, duke i mundësuar Mbrojtjes të angazhohet në mënyrë thelbësore me provat e dëshmitarëve"*. ('Aktvendimi mbi pranueshmërinë e deklaratave dhe ditarëve të A. Z. të datës 21 mars 2012, f. 14, nr.35). Kjo në veçanti dhe në mes tjerash do të përfshinte atë se Mbrojtjes i është dhënë kohë përgatitore e duhur, se janë marrë parasysh kompleksiteti i lëndës, si edhe rëndësia relative dhe statusi i dëshmitarit dhe se Mbrojtjes i është dhënë një nivel adekuatë i zbulimit të informacionit, i cili të paktën duhet të përfshijë të gjitha materialet që pengojnë lëndën e Prokurorisë apo që arsyeshëm mund të ndihmojnë lëndën e Mbrojtjes. Në veçanti kjo e fundit nuk është dhënë në lëndën në fjalë, sepse vetëm Dosjet A dhe B të PSRK-së, si dhe raportet e zhvarrimit të përfshira në Dosjen I dhe Dosjen L paraprakisht i janë zbuluar Mbrojtjes si edhe në kuadër të marrjes në pyetje në mes të 05 dhe 09 korrik 2011, përderisa, në këtë kontekst, veçanërisht e tërë Dosja C e PSRK-së nuk i ishte shpalosur Mbrojtjes. Për më tepër, PSRK-ja kishte dështuar të zbuloj deklaratat e GjNP për ish Jugosllavi të A. Z. në cilësinë e dëshmitarit për Mbrojtjen si edhe të tërë 'Ditarët e Luftës' dhe të dhënat psikiatrike të A. Z.
39. Gjykata Supreme e Kosovës pajtohet plotësisht me vlerësimet e Gjykatës së Qarkut në masën që shprehja *'mundësi'* e përdorur në Nenin 156 paragrafin 2 të KPPK-së përfshin atë se mundësia duhet të jetë reale dhe me kuptim, duke i mundësuar mbrojtjes të angazhohet në mënyrë esenciale me provat e dëshmitarit. Megjithatë, kjo është e padiskutueshme dhe nuk është kundërshtuar nga asnjëra palë pasi që, përndryshe e drejta do të ishte e thatë.
40. Kushtet e mundësisë për marrje në pyetje në mënyrë "adekuate dhe të duhur", sikurse janë interpretuar nga Gjykata e Qarkut është shtjelluar nga GjEDNJ përmes vendimeve të shumta, e që është arsyeja pse në kontekstin e dhënë duhet të përcaktohet se çfarë mund të jetë përmbajtja e këtyre kushteve dhe nëse ato janë apo nuk janë vërejtur si duhet në lëndën në fjalë.
41. Gjykata Supreme gjithashtu pajtohet me vlerësimin e Gjykatës së Qarkut, në veçanti, sa është kërkuar kohë e përshtatshme për përgatitjen e Mbrojtjes, e cila duhet të konsiderohet në lidhje me kompleksitetin e lëndës dhe rëndësinë relative si edhe statusin e dëshmitarit. E gjithë kjo është e nevojshme në interes të gjykimin të drejtë dhe të barazisë së armëve, dy aspekte këto të garantuar me Nenin 6 të KEDNJ-së dhe prandaj përtej të gjitha dyshimeve standarde evropiane.
42. Megjithatë, në lëndën në fjalë duhet të merret parasysh se të gjithë avokatët mbrojtës kanë qenë të njoftuar nga prokurori i PSRK-së më 27 qershor 2011 se në mes të 05 dhe 09 korrik 2011 ata do ta kenë mundësinë ta marrin në pyetje A. Z. në atë kohë në cilësinë e tij të dëshmitarit bashkëpunues. Në të njëjtën kohë, një sasi e madhe e materialeve relevante u është siguruar atyre nga prokurori i PSRK-së sikurse është rreshtuar në mënyrë të detajuar në *'Aktvendimin mbi Pranueshmërinë e Deklarimeve dhe Ditarëve të A. Z. të kundërshtuar, të datës 21 mars 2012 (f. 15 nr. 30 deri në f. 19 nr. 40 të versionit në anglisht)*. Prandaj të gjithë avokatët

mbrojtës i kanë ditur detajet e lëndës së prokurorisë dhe u është mundësuar të planifikojnë marrjen në pyetje në përputhje me rrethanat.

Siç mund të shihet nga të përmendurat më sipër, Mbrojtja - duke u pajisur edhe me material voluminoz përkatës - ka pasur më shumë se shtatë ditë para seancës së parë të marrjes në pyetje më 5 korrik 2011 për përgatitjen e tyre. Përveç kësaj, duhet të theksohet se gjatësia totale e katër seancave ishte rreth 19 orë, gjatë së cilës periudhë të gjithë avokatët mbrojtës ishin të pranishëm dhe kishin mundësinë për të marrë pjesë në marrjen në pyetje, për të dëgjuar atë nga kolegët e tyre dhe në kthim plotësimin e tyre në pyetje; që do të thotë, pasi një avokat kishte mbaruar marrjen në pyetje të dëshmitarit, ai ka mundur të bëjë pyetje të mëtejshme më vonë në qoftë se ai ka dashur të bëjë. Sipas procesverbalit, edhe të pandehurit N. KR., N. K. dhe S. SH. kanë qenë të pranishëm gjatë të gjitha seancave, ndërsa i pandehuri F. M. ishte i pranishëm vetëm më 07 dhe 09 korrik 2011. Marrja në pyetje është bërë para prokurorit i cili ka për detyrë të shqyrtojë provat shfajësuese si edhe fajësues në pajtim me Nenin 46 paragrafin 3 të KPPK-së. Prokurori i PSRK-së nuk ka vendosur asnjë kufizim çfarëdo qoftë në pyetjet që kanë mundur të bëhen, dhe për këtë arsye avokatët mbrojtës dhe të pandehurit ishin të lirë të bëjnë ndonjë pyetje që ata dëshironin dhe në shumicën e tyre dërrmuese edhe bënë kështu. Vetëm një avokat mbrojtës vendosi të mos bëjë asnjë pyetje për shkak të interpretimit të tij të ligjit, në veçanti të Nenit 338 të KPPK-së. Në të vërtetë, mbi 1000 (një mijë) pyetje janë bërë, duke përfshirë mbi 500 pyetje nga ana e Mbrojtjes për F. L. dhe pyetjet e përgjigjet kanë marrë rreth 86 faqe transkriptim në versionin anglisht. Po ashtu është bërë video incizimi i seancave.

Gjykata Supreme vëren se në kontekstin e dhënë prokurori i PSRK nuk ka bërë asnjë pyetje për dëshmitarin, por menjëherë dhe në mënyrë ekskluzive i ka dhënë fjalën Mbrojtjes. Megjithatë, prandaj kjo gjendje nuk përbën aspak kushtet e një 'marrje përsëri në pyetje' sikurse kërkohet nga Gjykata e Qarkut, prapë se prapë i plotëson kushtet e një 'mundësi për ta kundërshtuar' sikurse përcaktohet me Nenin 156 paragrafin 2 të KPPK-së. Përsëri duhet të theksohet se dispozita e përmendur nuk kërkon aspak një "marrje përsëri në pyetje". Po ashtu Gjykata Supreme nuk shqetësohet se në këtë mënyrë mbrojtja nuk është 'udhëhequr' disi me një katalog të pyetjeve që PSRK-ja ka mundur t'i parashtrijë gjatë marrjes në pyetje. Pa marrë parasysh, ky katalog i pyetjeve nuk është detyrues për prokurorin gjatë zhvillimit të mëturësishëm të hetimeve dhe para gjykatës, po ashtu nuk ekziston asnjë obligim ligjor për prokurorin që të vazhdojë në atë mënyrë. Në fund, por që është njësoj e rëndësishme, në këtë kontekst është shumë me rëndësi që mbrojtja i kishte siguruar të gjitha dëshmitë e A. Z. mjaft kohë para se të fillonte marrja në pyetje. Pasi që të gjitha këto dëshmi janë të shkruara në formë të pyetjeve që i ka bërë policia dhe prokurori i PSRK-së dhe të përgjigjeve të A. Z. mbrojtja kishte baza të mjaftueshme për t'i përgatitur dhe kuptuar pyetjet e prokurorit të PSRK-së.

43. Në bazë të asaj që u tha më parë, Gjykata Supreme gjen se mbrojtjes i është dhënë mjaft material dhe kohë përgatitore, po ashtu duke marrë parasysh natyrën komplekse të lëndës në fjalë dhe rëndësinë relative të A. Z. si dëshmitar. Prandaj, nuk mund të konstatohet asnjë shkelje e nenit 6 të KEDNj-së.

44. Gjykata e Qarkut ka kërkuar që një shkallë adekuate e zbulimit të informatave t'i ofrohet mbrojtjes, mirëpo gjykata iu referohet gjërave që janë thënë

paraprakisht lidhur me këtë çështje. Dosjet e PSRK-së A dhe B janë zbuluar për mbrojtjen paraprakisht, të cilat përmbajnë të gjitha deklaratimet përkatëse të A Z si dhe material të tjera. Për më shumë, mbrojtja gjatë zhvillimit të marrjes në pyetje në mes 05 dhe 09 korrikut 2011 ka pranuar raportet e zhvarrimit të cilat janë në Dosjen I dhe Dosjen L. Gjykata Supreme prandaj gjen se mbrojtja i kishte në posedim të gjithë materialin kritik, të cilin mbrojtja e kishte siguruar në përputhje siç kërkohet me ligj. Në këtë kontekst, vlen të përmendet se në pajtim me nenin 307 të KPPK-së prokurori është i obliguar t'i zbulojë të gjitha materialet përkatëse mbrojtjes përderisa nuk është ngritur ende aktakuza. Pasi që në lëndën konkrete aktakuza është ngritur vetëm më 25 korrik 2011 pra pas datave të marrjes në pyetje, prokurori i PSRK-së nuk ishte i obliguar t'ia zbulojë mbrojtjes të gjithë materialin që e kishte.

Duke pasur parasysh se kjo praktikë gjatë fazës së hetimit është plotësisht në pajtim me gjykimin e GjEDNj-së, sipas së cilës "[...] marrja në pyetje mund të ndodhë sapo jepen deklaratimet."² dhe megjithëse mbrojtja në lëndën konkrete i kishte marrë të gjitha materialet kritike të nevojshme për ta marrë në pyetje A Z duket se pyetja e vetme se është apo nuk është me rëndësi se në veçanti e tërë Dosja e PSRK-së C, në mes deklaratimeve të tjera të dëshmitarëve të tjerë, nuk iu zbulua mbrojtjes në këtë kontekst dhe se PSRK-ja njashtu nuk i ka zbuluar mbrojtjes as deklaratimet e A Z në GjNP në cilësi të dëshmitarit e as tërë 'Ditarët e Luftës' dhe të dhënat psikiatrike të A Z dhe kjo ishte kritikuar nga Gjykata e Qarkut.

Në përgjithësi pohohet se KPPK-ja nuk kërkon që i gjithë materiali i prokurorisë duhet të jetë në dispozicion të palëve të tjera para marrjes në pyetje sikurse në rastin konkret.

45. **Lidhur me Dosjen e PSRK-së C** në veçanti Gjykata Supreme gjen se edhe në rast se këto dokumente nuk ishin zbuluar para ngritjes së aktakuzës në përputhje me nenin 307 të KPPK-së, KPPK-ja nuk do ta sanksionojë këtë. Sa i përket 'Ditarëve të Luftës' Gjykata Supreme shënon se së paku të gjitha pjesët që konsiderohen të rëndësishme për prokurorin PSRK-së i janë zbuluar mbrojtjes. Fakti se nuk janë zbuluar të gjithë ditaret nuk mund të qojë deri te papranueshmëria e deklaratimeve të dëshmitarit për shkak të *'mundësisë për t'i kundërshtuar'* ato.

46. **Sa i përket deklaratimeve të A Z në GjND** duhet të theksohet se ato janë pjesë të një lënde tjetër dhe prandaj nuk janë obligim i prokurorit për t'i zbuluar materialet e lëndës për marrje në pyetje të dëshmitarit bashkëpunues.

47. **Si i përket të dhënave psikiatrike të A Z** duhet të përmendet në kontekstin e dhënës se ato nuk kanë qenë domosdo me rëndësi të veçantë për marrjen në pyetje të dëshmitarit, pasi që gjatë tërë rrjedhës së hetimit dhe marrjes në pyetje pretendohet se nuk ka shfaqur asnjë shenjë të problemeve të shëndetit mendor.

48. Sado që vlerësimi i ndryshëm i Gjykatës së Qarkut ka mundur të ndikohet nga propozime mbrojtjes, sipas të cilëve pyetjet e tjera do të bëheshin të dukshme nëse kishin pasur qasje të pakufizuar në të gjitha materialet në posedim të prokurorisë, duhet të theksohet se mbrojtja asnjëherë nuk ka provuar se cilat do të kishin qenë ato pyetje.

² Ibid.

49. Sidoqoftë, Gjykata Supreme mendon se ka nevojë të nënvizojë se në përputhje me nenin 142 të KPPK-së avokatët mbrojtës kishin vazhdimisht të drejtë të inspektionin dosjen complete të prokurorit, të cilën të drejtë e kanë shfrytëzuar së paku dy prej tyre gjatë zhvillimit të hetimit dhe para seancave të marrjes në pyetje në korrik 2011. Nuk mund të jetë argument i mbështetjes së idesë së papranueshmërisë së provave të dëshmitarit, tani kur avokatët e tjerë mbrojtës vullnetarisht zgjodhën të mos i inspektionin këto dosje. Vlen të përmendet edhe se jo vetëm në kuptim të nenit 6 paragrafit 1 të KEDNj-së por edhe të nenit 10 paragrafit 1 të KPPK-së, ku të dy nenet vërtetojnë parimin e barazisë së armëve në ligjin e procedurës penale të Kosovës, avokatët mbrojtës ishin përherë të lirë të kërkonin dëgjimin e A. Z. në përputhje me nenin 238 të KPPK-së (që asnjë herë nuk e kanë bërë).

Pikëpamja e lartpërmendur mbështetet edhe nga jurisprudenca e vazhdueshme e GJEDNJ-së, në bazë të së cilës veçmas shkelja e parimit të barazisë së armëve siç përcaktohet edhe me nenin 6 paragrafin 3 pikën (d) të KEDNj-së është vërtetuar vetëm në lëndët ku mbrojtja nuk ka pasur absolutisht asnjë mundësi ta marrë në pyetje fare dëshmitarin dhe përveç kësaj dënimi ka qenë i bazuar bindshëm vetëm në deklaratime të tilla të dëshmitarit. Në një numër të konsiderueshëm të lëndëve GJEDNJ-ja për më tepër ka përcaktuar se madje edhe mungesa e konfrontimit të dëshmitarit me deklaratimet e tij me shkrim nuk përbën shkelje të parimit të barazisë së armëve nga neni 6 paragrafi 1 dhe paragrafi 3 pika (d) e KEDNj-së.³ dhe në një rast shumë të freskët, Gjykata madje është tërhequr nga pika e vetme ose vendimtare, përderisa ekzistojnë faktorë të mjaftueshëm kundërpeshues që lejojnë vlerësimin e drejtë dhe të duhur të besueshmërisë së provave⁴.

Megjithatë, sa i përket aspekteve të diskutimit në lënë konkrete GJEDNJ-ja në aktgjykimin e mëhershëm në lëndën *Melnikov kundër. Rusicë*⁵ ka nënvizuar disa faktorë të caktuar që duhet marrë parasysh kur bëhet vlerësimi nëse mundësia e marrjes përsëri në pyetje të dëshmitarit të supozuar kishte qenë e drejtë dhe adekuate. Në këtë lëndë dënimi i të pandehurit deri në një shkallë vendimtare ishte i bazuar në deponimin e të bashkakuzuarit ne procedurën paraprake i cili më vonë u arratis. Gjatë fazës së procedurës paraprake ishte përgatitur ballafaqimi në mes tij dhe të pandehurit para hetuesit. Avokati i të pandehurit nuk ishte i pranishëm ne këtë ballafaqim (prandaj në mungesë të këshillës juridike i pandehuri nuk kishte mundësi ta kuptonte procedurën e ballafaqimit dhe nuk mund ta shfrytëzonte te drejtën e tij në mënyrë efektive); ballafaqimi u zhvillua nga një hetues që kishte pushtet të madh për t'i bllokuar pyetjet; qeveria përkatëse nuk tregoi se ishin bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për ta sjellë dëshmitarin para gjykatës; dhe nuk kishte asnjë video incizim te deklaratimit të dëshmitarit që gjykata e shkallës së parë të mund ta vështronte sjelljen e tij gjatë marrjes në pyetje për ta krijuar përshtypjen e vet të besueshmërisë.

50. Duke marrë parasysh këta faktorë të nënvizuar nga GJEDNJ-ja, gjendja faktike në këtë lëndë është diametralisht e kundërt dhe qon nga një konkluzion i kundërt sa i

³ Shih p.sh. *Asch kundër. Austrisë*, App. nr. 12398/86, Aktgjykim i datës 26 prill 1991; *Gossa kundër Polonisë*, App. nr. 47986/99, Aktgjykim i datës 9 janar 2007; *Ferrantelli kundër Italisë*, App. nr. 19874/92, Aktgjykim i datës 7 gusht 1996.

⁴ *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, App. nr. 26766/05 dhe 22228/06, 15 dhjetor 2011

⁵ *Melnikov kundër. Rusicë*, App. nr. 23610/03, Aktgjykim i datës 14 janar 2010.

përket standardit të drejtë dhe adekuat të mundësisë. Përkitazi me përfundimet e Gjykatës Supreme, referimi i plotë i bëhet asaj që u tha me herët (kapitulli B I pika 2, f. 18 e aktvendimit në versionin në gjuhën angleze).

4. Pretendimi mbi 'fushën' e pamjaftueshme të dëgjimit të A. Z. mes 05 dhe 09 korrikut 2011:

51. Gjykata e Qarkut përveç kësaj ka marrë qëndrim se prokurori i PSRK-së, kur e ftoi mbrojtjen për ta marrë në pyetje A. Z. mes 05 dhe 09 korrikut 2011, ka luajtur një rol tepër pasiv dhe çorientues kur vetëm ka përsëritur se ai thjesht ishte duke i dhënë mbrojtjes një mundësi për ta marrë në pyetje A. Z. "lidhur me hetimin e tanishëm". Prokurori Special veçmas ka pohuar se "ky dëgjim në mënyrë specifike është caktuar për t'ju dhënë mundësi për t'i kundërshtuar deklaratat e dëshmitarit bashkëpunues A. Z. [...prandaj...] nëse e konsideroni të domosdoshme, ju mund t'ia parashtroni çfarëdo lloj pyetjesh lidhur me hetimin e tanishëm kundër klientëve tanë" dhe se "kjo është një mundësi që po ua jap sot. Nëse doni ta shfrytëzoni, mirë, nëse jo, varet nga ju" Në këtë mënyrë dhe duke pohuar se "nuk e dimë nëse kemi shqyrtim gjyqësor" dhe "nëse kemi shqyrtim gjyqësor do ta respektojmë afatin", Prokurori Special e çorientonte mbrojtjen lidhur me rëndësinë e marrjes në pyetje të A. Z. dhe i ka bërë të supozojnë se ky i fundit do të jetë përsëri në dispozicion për ta marrë në pyetje në një fazë të mëvonshme të procedurës.

52. Gjykata Supreme nuk pajtohet me vlerësimin e Gjykatës së Qarkut përkitazi me këtë. Gjykata iu referohet gjërave që janë thënë paraprakisht lidhur me 'mundësinë për të kundërshtuar', siç përcaktohet me nenin 156 paragrafin 2 të KPPK-së. Në veçanti, mbrojtja ka përgjegjësi të që ta parashtrorë lëndën e tyre dhe të jenë sa më të përgatitur për pyetjet gjatë seancave të marrjes në pyetje që u janë siguruar atyre. Sa i përket qasjes së pretenduar pasive të prokurorit të PSRK-së nuk mund të vërtetohet asnjë obligim i këtij të fundit të ketë motivuar aktivisht avokatët mbrojtës për të bërë hulumtim të duhur dhe me kujdes, që është në interesin e tyre profesional dhe në interesin e klientëve të tyre. Po ashtu 'detyra e prokurorit publik të analizojë provat dhe faktet fajësuese dhe shfajësuese gjatë hetimit të veprave penale dhe të sigurojë që hetimi të kryhet duke respektuar në tërësi të drejtat e të pandehurit', siç përcaktohet me nenin 46 paragrafin 3 të KPPK-së, nuk mund të interpretohet në mënyra kaq të gjerë.

Në lëndën konkrete siç është potencuar edhe më herët, mbrojtja kishte mundësi t'ia parashtronte A. Z. mbi 1000 pyetje dhe prokurori i PSRK-së nuk e ndali asnjërin prej tyre, madje dhe kur ato kishin karakter orientues/çorientues.

Argumentimi i Gjykatës së Qarkut se ftesat e prokurorit drejtuar mbrojtjes siç përmendet më parë kishte qenë çorientuese kur dhanë përshtypje të gabuar se do të ketë edhe mundësi të tjera për ta kundërshtuar A. Z. mbetet tërësisht enigmatike. Pavarësisht se formulimet e cituara të prokurorit nuk qojnë fare nga ky drejtim, askush, e as prokurori i PSRK-së, nuk është pritur të jetë kaq parashikues-që paraprakisht të dijë se A. Z. do të vdiste në fund të shtatorit pasues dhe se kështu nuk do të ishte në dispozicion më si dëshmitar në shqyrtim gjyqësor.

Po ashtu argumenti se prokurori i PSRK-së e kishte përfshirë A. Z. në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve në këtë pikëpamje nuk mund të përdoret në dëm të prokurorit. Vendimi përkatës ishte marrë duke u bazuar në përvojat e mëparshme në lëndë et tjera të ngjashme dhe duke marrë parasysh tentimet e vazhdueshme të pretenduara për të ushtruar ndikim që A. Z. të mos vazhdojë bashkëpunimin e tij me policinë dhe me prokurorinë ose që t'i tërheqë deklaratat e tij që tanimë i kishte dhënë. Për përfshirjen e A. Z. në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve, prokurori mori parasysh rrezikun abstrakt se dikush mund të tentojë ta vrasë apo t'i shkaktojë diç të keqe deri në atë masë sa të pengojë zhvillimin e procedurës penale në Kosovë. Mirëpo, askush nuk ka mundur ta dijë se A. Z. do të bënte vetëvrasje.

II. PAPANUESHMËRIA E PRETENDUAR E DEKLARATAVE TË A. Z. PËR SHKAK TË PARALAJMËRIMIT TË GABUAR:

53. Gjykata e Qarkut – mes tjerash – ka bazuar mendimin e vet mbi papranueshmërinë e deklarimeve të A. Z. në vlerësimin se A. Z. ka marrë paralajmërime të ndryshme për të drejtat dhe detyrat e tij, gjithnjë duke u varur në statutet e ndryshme që i kishte si dëshmitar, si i pandehur ose si dëshmitar bashkëpunues. Pasi në raundin e fundit të marrjes në pyetje në mes 05 dhe 09 korrikut 2012, kur A. Z. ishte marrë në pyetje si dëshmitar bashkëpunues, prokurori special nuk ka arritur ta pyeste t'i përsëriste ose t'i konfirmonte përmbajtjet e deklarimeve të tij të mëparshme, të cilat do të duhej të konsideroheshin të papranueshme për shkak të paralajmërimeve të ndryshme që i ishin bërë në atë kohë. Përveç kësaj, deklaratat e A. Z. të dhëna para PSRK-së në mes 04 shkurtit dhe 29 gushtit 2010 në cilësi të të pandehurit do të ishin të papranueshme. Paralajmërimi i bërë të të pandehurit në përputhje me nenin 231 paragrafin 2 të KPPK-së do të ishin jo të plota, pasi që nuk i është referuar asnjëherë nenit 231 paragrafit 2 pikave 5 dhe 6 të KPPK-së dhe i pandehuri nuk ishte paralajmëruar se deklaratat e tij mund të përdoren si prova para gjykatës dhe se kishte të drejtë të paraqiste material për mbrojtjen e tij.

54. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se asnjëri deklaratim i A. Z. nuk është i papranueshëm për shkak të paralajmërimit jo të duhur të tij në cilësi të dëshmitarit, të të pandehurit ose të dëshmitarit bashkëpunues.

55. A. Z. ka deklaruar në cilësinë e tij si dëshmitar para NjHKL të policisë së EULEX-it më 20 dhe 30 nëntor 2009 si dhe më 03 dhjetor 2009.

Rishikimi i deklaratimeve të mbyllura tregon se dy protokollet janë të datës 20 nëntor 2009, por bashkëngjitur për njërin nga to janë skicat e vizatuara nga A. Z. të datës 30 nëntor 2009. Prandaj supozohet se e tërë deklaratim ishte dhënë në këtë datë të mëvonshme dhe se data 20 nëntor është vetëm një gabim shtypi.

Gjykata Supreme gjen se paralajmërimet e A. Z. nga NjHKL-ja më 20 dhe 30 nëntor dhe më 03 dhjetor 2009 bazohen në nenin 164 të KPPK-së dhe prandaj janë në përputhje me ligjin.

56. Rrethi i dytë i deklaratave të A. Z. ishin dhënë në cilësinë e të dyshuarit/të të pandehurit para prokurorit të PSRK-së përmes dhjetë seancave më 4, 9, 11, 16 dh 17 shkurt 2010, më 10, 16 dhe 25 mars 2010, më 06 qershor dhe më 20 gusht 2010. Sipas tri deklaratimeve të para të datës 04, 09 dhe 11 shkurt 2010, ai thjesht i konfirmoi, paragraf pas paragrafi, deklaratimet e dhëna më parë para policisë së EULEX-it /NjHLK në nëntor dhe dhjetor 2009 duke pranuar sjelljet e tij kriminale lidhur me vrasjen e dy serbëve. Deklarimet e mbetura kanë të bëjnë me situatën e pas luftës, përfshirë teorinë e tij të evolucionit përkritazi me përfshirjen negative të të pandehurit në jetën e tij, dhe me foto identifikimin e të pandehurve dhe të tjerëve.

Neni 156 paragrafi 1 i KPPK-së vërtetë përcakton se '[Deklarimi] i të pandehurit dhënë policisë ose prokurorit publik mund të jetë provë e pranueshme në gjykatë vetëm kur është marrë në pajtim me dispozitat e nenit 229 deri në 236 të këtij Kodi'. Prandaj, paralajmërimi i drejtë, siç përcaktohet me nenin 231 paragrafin 2 të KPPK-së, është vendimtar për pranueshmërinë e provave të siguruara nën rrethanat e përshkruara.

Në të gjitha rastet e përmendura më lart A. Z. është paralajmëruar në përputhje me nenin 231 paragrafin 1 të KPPK-së në mënyrë të duhur për marrjen në pyetje të të pandehurit. Megjithatë, të gjitha paralajmërimet ishin reduktuar në aspektin siç u adresua në nenin 231 paragrafin 2 pikat 1 deri në 4 të KPPK-së, kurse A. Z. nuk ishte paralajmëruar se deklaratimet e tij mund të përdoren si prova para gjykatës dhe se ai mund të kërkojë që provat të merren në mbrojtjen e tij, siç kërkohet me nenin 231 paragrafin 2 pikat 5 dhe 6 të KPPK-së, gjë të cilën Gjykata e Qarkut e kishte kritikuar në veçanti.

57. Gjykata Supreme gjen se edhe këto paralajmërimet jo të plota të bëra për A. Z. janë të mjaftueshme dhe në veçanti nuk rezultojnë me papranueshmërinë e këtyre deklaratimeve.

Qëllimi esencial i pjesës së paralajmërimit që mungon është ta mbrojë vetë të pandehurin nga vetë inkriminimi me fjalë të veta, që do të përdorej kundër tij gjatë gjyqimit.

Sipas Ligjit të Kosovës, kjo pikëpamje mbështetet nga fjalia e dytë e nenit 156 paragrafit 1 të KPPK-së e cila përcakton se deklarimi i të pandehurit dhënë policisë ose prokurorit publik 'mund të përdoret për ta kundërshtuar deklaratimin e të pandehurit në gjyq...' si dhe neni 157 paragrafi 2 i KPPK-së siç përmendet më lart e bën të qartë se deklarimi i të pandehurit dhënë policisë ose prokurorit mund të pranohet si provë.

58. Praktika gjyqësore siç u nënvizua më lart është po ashtu edhe në pajtim me standardet Evropiane, sikurse mund të gjenden në shumë sisteme të tjera ligjore Evropiane kontinentale. Një dispozitë mjaft e ngjashme me nenin 231 paragrafin 2 të KPPK-së mund ta gjejmë p.sh. në nenin 136 paragrafin 1 të Kodit të Procedurës Penale të Gjermanisë (Strafprozessordnung (StPO)). Është pothuajse e nënkuptueshme në mes përfaqësuesve të literaturës ligjore dhe jurisprudencës gjyqësore se shkëlja e pjesshme e kushteve të paralajmërimit siç u theksua më lart nuk rezulton me papranueshmëri të deklarimit si provë në rast se i pandehuri ishte në

dijeni për të drejtat e tij edhe pa paralajmërim⁶. Së fundi kjo ishte konfirmuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme Federale të Gjermanisë (Bundesgerichtshof (BGH)) në lëndën 4 StR 455/08, të datës 18 dhjetor 2008; pika 16 dhe 18, që i referohet jurisprudencës së përhershme të Gjykatës Supreme Federale (BGH) se mos paralajmërimi i të pandehurit lidhur me të drejtat e tij mund ketë rëndësi në rast se i pandehuri ishte i privuar nga mbrojtja e tij kundër deklarimit të tij të ngutshëm në dëm të tij.

Në lëndën konkrete është e qartë se A. Z. ishte i vetëdijshëm për domethënien e deklarimeve të tij dhe e dinte se ajo që e ka thënë mund të përdoret kundër tij dhe kundër të pandehurve në gjyq. A. Z. u lajmërua vullnetarisht te NjHKL në polici të EULEX-it në nëntor dhe dhjetor 2009 dhe si pasojë ishte marrë në pyetje nga prokurori i PSRK-së në dhomat zyrtare. Është e vetëkuptueshme se prokurori i PSRK-së nuk i zhvillon dëgjimet e tilla vetëm për qejf por për qëllim të hetimit dhe në fund për të ngritur aktakuzë në gjykatë. A. Z., i cili – siç u përmend më lart – vazhdimisht e kishte pranuar pjesëmarrjen e tij në kryerjen e disa prej krimeve për të cilat po diskutohet, po ashtu ishte i vetëdijshëm se po merrej në pyetje si i pandehur, për shkak të paralajmërimeve që iu ishin bërë. Vërtetë, arsyeja kryesore që ai u paraqit ishte t'i pranonte krimet e tij dhe t'i implikonte të pandehurit në krimet e njëjta, me qëllim që t'i siguronte organet me informata të domosdoshme për ta nisur hetimin dhe për ta filluar procedurën gjyqësore. Duke u bazuar në vlerësimin e Gjykatës Supreme, kjo është një situatë kur një person pa dashje bën një deklaram që nuk e ka idenë se kjo do të përdoret në procedurë më pastaj.

Për më shumë duke marrë parasysh faktin se në fazën e mëvonshme të procedurës A. Z. iu pranua statusi i dëshmitarit bashkëpunues, nga ajo kohë ai nuk iu nënshtrua më hetimit dhe ndjekjes penale përkitazi me lëndën konkrete. Prandaj, së paku prej asaj kohe e tutje A. Z. më nuk kishte interes për mbrojtje siç ofrohet me paralajmërimin nga neni 231 paragrafi 2 pikat 5 dhe 6 të KPPK-së. Përkundër tërë kësaj dhe duke marr parasysh faktin që A. Z. ka vdekur prandaj edhe nuk është më subjekt i ndonjë hetimi penal apo procedure gjyqësore, duke rezultuar në faktin që gjithashtu sipas këtij aspekti nuk ekziston më nevoja që më tutje të diskutohet nevojat për mbrojtjen e tij, e gjithashtu është në linjë me standardet evropiane që shkelja e kërkesave paralajmëruese kundër një të bashkë-pandehuri (në rastin në fjalë A. Z. nuk e pengon pranueshmërinë e deklaratave të pandehurit përkatës në rrjedhën e procedurës kundër të bashkë-pandehurve të tjerë⁷.

59. Kjo traditë ligjore është relevante në veçanti sa i përket faktit që sipas KPPK-së e gjithashtu në tërë sistemet kontinentale ligjore evropiane, i pandehuri nuk është i detyruar të tregojë të vërtetën lidhur me pjesëmarrjen e tij në veprimtaritë penale kur deklarohet para gjykatave.

Megjithatë, përkundër që vlerësimi i besueshmërisë së të pandehurit duhet të zbatohet nga gjykata së bashku me vlerësimin e të gjitha provave tjera të pranueshme në fund të procedurës së provave dhe jo brenda përzierjes së pyetjeve të pranueshmërisë dhe besueshmërisë, siç është shtjelluar më parë në këtë aktgjykim, duhet të nënvizohet që

⁶ Meyer-Gossner, Lutz; Strafprozessordnung mit GVG und Nebengesetzen; Kurz-Kommentar; 47. Auflage, Mynih 2004; Neni 136; nr. 20

⁷ Në mes tjerësh BGH në Zeitschrift fuer Wirtschafts- und Steuerstrafrecht (wistra) 2000, fq.311 (313); Meyer-Gossner; ibid., nr.20

e drejta e të pandehurit që të mbrojë veten në heshtje ose mos të pranojë sinqerisht pjesëmarrjen e tij në çfarëdo aktivitete penale është rezultat i drejtpërdrejtë të parimit të prezumimit të pafajësisë siç parashihet për sistemin ligjorë në Kosovë në nenin 3 paragrafit 1 të KPPK-së. Nuk është në rregull që i pandehuri automatikisht të lejohet para gjykatave, në veçanti kur ka të bëjë për përfshirjen e pretenduar të tjerëve në kryerjen e krimeve. Gjithashtu, në Kosovë është e kundërligjshme për të bërë raportim të rrejshëm të krimit dhe e dënueshme me nenin 306 të Kodit Penal të Kosovës (KPK). Në pajtim me nenin 306 paragrafit 1 të KPK-së në veçanti është krim që përfshihen rrejshëm personat tjerë në kryerjen e krimit, siç do të konsiderohej veprë penale për personin që të raportoj që ai ose ajo ka kryer krime sipas nenit 3 të dispozitës së përmendur.


60. Prandaj, Gjykata Supreme gjen se paralajmërimet jo të plota të ofruara A. Z. para marrjes së tij në pyetje më 4, 9, 11, 16 dhe 17 shkurt 2010, më 10, 16 dhe 25 mars 2010, më 6 qershor dhe më 20 gusht 2010 nuk shpijnë në papranueshmërinë e deklaratave të dhëna aty.

Nëse kolegji i rigjykitimit i shkallës së parë duhet megjithatë arrin që ketë dyshime të mëtejshme faktike lidhur me këtë, Gjykata Supreme rekomandon që të merret parasysh që prokurori i PSRK-së të ftohet si dëshmitarë dhe të deklarohet nëse është ofruar paralajmërim i duhur A. Z.

61. A. Z. për më tepër ka deklaruar në cilësinë e tij si dëshmitar bashkëpunues tek prokurori i PSRK-së më 5 dhe 7 tetor 2010, pasi që ishte deklaruar si dëshmitar bashkëpunues nga gjyqtari i procedurës paraprake me kërkesën e prokurorit të PSRK-së dhe pas seancës dëgjimore siç kërkohet nga neni 300 paragrafit 1 të KPPK-së.

62. Edhe pse ai është paralajmëruar në mënyrë të duhur në pajtim me nenin 164 të KPPK-së dhe për më tepër e ka kuptuar veten që është dëshmitar bashkëpunues, kështu duke deklaruar kështu tek prokurori, Gjykata e Qarkut ka shprehur shqetësim që sapo që A. Z. të bëhet dëshmitar bashkëpunues, procesi i marrjes në pyetje duhet të fillohet përsëri dhe të gjitha deklaratat e mëparshme duhet të jenë të papranueshme sipas fjalive të cituara.

63. Gjykata Supreme gjen se ky vlerësim është i pabazuar. Edhe pse neni 300 paragrafi 1 i KPPK-së me të vërtetë përcakton në fjalinë e tij të fundit që *'deklarimet e bëra te gjyqtari gjatë marrjes në pyetje nuk mund të përdoren në procedurë penale kundër dëshmitarit bashkëpunues ose kundër ndonjë personi tjetër si prova që mbështesin zbulimin e fajësisë'* është e padyshimtë që kjo dispozitë i referohet vetëm deklaratave të dhëna gjyqtarit gjatë marrjes në pyetje sipas nenit 300 të KPPK-së që kanë për qëllim të përcaktojnë nëse kërkesa për dhënie e statusit të dëshmitarit bashkëpunues është e bazuar. Megjithatë, nuk i referohet asnjë deklaratë të dhënë më parë ose në çfarëdo ekzaminimi tjetër. Kjo sqaron prej gjuhës së dispozitës së referuar, e cila shpreh bisedat lidhur *'me këtë ekzaminim'* e gjithashtu prej pozitës së saj sistematike në kapitullin mbi dëshmitarët bashkëpunues dhe *ratio legis* të tij, duke qenë të kufizuar në procedurën e përcaktimit të besueshmërisë së personit, këtu të A. Z. për të parë nëse ai kualifikohet si dëshmitar bashkëpunues sipas nenit 298 të KPPK-së.



Edhe pse me siguri ka qenë e këshillueshme për prokurorin e PSRK-së që të sigurohet që tani dëshmitari bashkëpunues të merret në pyetje përsëri lidhur me të gjitha deklaratat e tij të mëparshme, KPPK-ja nuk e kërkon këtë. Për më tepër, asnjë arsye nuk mund të gjendet, se pse deklaratat që ishin përfshirë në kërkesën për marrjen e statusit të dëshmitarit bashkëpunues dhe të cilat kanë formuar pjesën e bazës së aktvendimit të gjyqtarit procedurës paraprake, duhen të jenë të papranueshme. Sapo që personi të vërtetohet që është i besueshëm nga gjyqtari i procedurës paraprake në bazë të dëshmisë së tij gjatë seancës dëgjimore dhe materialeve që janë në kërkesën e prokurorit, duke përfshirë deklaratat e mëparshme, do të kishte pak kuptim që të vendoset për këto deklarata të mëparshme si të pabazuara. Për më tepër, gjatë tërë fazave të mëparshme të procedurës A. Z. ka theksuar në cilësi të ndryshme si dëshmitar dhe i pandehur por gjithmonë është - siç është vërtetuar më parë - paralajmëruar në mënyrë të duhur ose në mënyrë të mjaftueshme lidhur me të drejtat dhe detyrat, i cili fakt tashmë rezulton në pranueshmërinë e këtyre deklaratave. Kështu, Gjykata e Qarkut me përfundimin e saj përkatës këtu në mënyrë të qartë ka hartuar rrethin vicioz të argumenteve.

64. Mund të shërbej si një argument shtesë - siç është diskutuar më herët - që mbrojtja i ka pasur kopjet e deklaratave të ndryshme të A. Z. kur ata e kanë marrë në pyetje atë në korrik të vitit 2011. A. Z. pasi që është paralajmëruar të tregojë të vërtetën, kurrë nuk është lëkundur prej deklaratave të tij, e që përfaqëson konfirmim të dukshëm në vete.

65. Për më tepër, Gjykata e Qarkut është e shqetësuar sepse prokurori i PSRK-së, ashtu të thuhet në autoritetin e tij dhe pa përfshirjen e serishme të gjyqtarit të procedurës paraprake, ka zbuluar deklaratat e A. Z. të shënuara si B1-B9 mbrojtjes në përgatitjen e marrjeve në pyetje të korrikut 2011. Shqetësimi i Gjykatës së Qarkut në veçanti i bazuar në faktin që sipas kërkesës së prokurorit, gjyqtari i procedurës paraprake ka vendosur që materialet në kërkesë, përfshirë deklaratat e shënuara si B1-B9, të mbahen të fshehta, por që aktvendimi nuk ka ofruar ndonjë afat kohorë për urdhrin e fshehtësisë.

66. Gjykata Supreme gjen se përkundër të gjitha gabimeve procedurale kjo situatë nuk mund të arrijë në papranueshmërinë e deklaratave përkatëse.

Është e qartë që qëllimi i kërkesës dhe urdhrin të fshehtë sipas nenit 298 të KPPK-së ishte të mbrohet integriteti i hetimit në vazhdim e sipër të prokurorit kështu që ka qenë logjik në kohën kur është vendosur. Pasi që urdhri ishte lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake në pajtim me kërkesat e ligjit, prokurori do të duhet të merrte urdhrin e gjykatës për ti lejuar atij që të zbulojë deklaratat kështu që ka vepruar duke shkelur kompetencat e tij, kur ai i ka zbuluar dokumentet sipas autoritetit të tij të pretenduar dhe pa lejen e zakonshme formale të gjyqtarit të procedurës paraprake. Megjithatë, deklaratat që moti janë bërë pjesë e kësaj lënde, dhe janë përdorur nga mbrojtja kur ata e kanë marrë në pyetje A. Z. në korrik të vitit 2011.

III. PAPRANUESHMËRIA E PRETENDUAR E DEKLARATAVE TË
A. Z. PËR SHKAK TË MUNGESËS SË NËNSHKRIMIT
SIÇ KËRKOHEM ME LIGJ:

67. Si arsye shtesë për papranueshmërinë e pretenduar e gjithë deklaratave të A. Z. Gjkata e Qarkut ka gjetur se secila prej deklaratave të referuara janë nënshkruar nga A. Z. vetëm në faqen e fundit. Kjo do të ishte në kundërshtim me kërkesat e nenit 89 paragrafit 2 të KPPK-së, sipas të cilit personi i marr në pyetje duhet të ofrojë nënshkrimin e tij/saj në secilën faqe të deklaratave. Gjithashtu, kjo do të mund të kontribuonte në papranueshmërinë e deklaratave të referuara.

68. Gjykata Supreme gjen se mungesa e nënshkrimeve të A. Z. në secilën faqe të deklaratave nuk e dëmton pranueshmërinë e tyre.

Qëllimi i nenit 89 paragrafit 2 të KPPK-së është të sigurojë që ai që merret në pyetje ka lexuar dhe kuptuar versionin e shkruar të deklaratës së tij apo saj. Në lëndën në fjalë është e pakontestueshme që asnjë version të deklaratave me shkrim nuk i është ofruar A. Z. por që të gjitha këto dokumente janë mbajtur vetëm në gjuhën angleze.

Megjithatë, Gjykata Supreme gjen se secila deklaratë i është lexuar A. Z. në gjuhën shqipe nga përkthyesi shqiptar para se A. Z. të nënshkruante. Është vërtetuar prandaj që secila deklaratë përfundonte me vërtetimin vijues ose variantit nga kjo: *'Deklarata më është lexuar në gjuhën angleze dhe është përkthyer fjalë për fjalë në gjuhën shqipe dhe unë e vërtetoj që është e imja dhe unë e nënshkruaj pa kurrfarë kundërshtimi.'* Përkundër kësaj, dështimi për të siguruar nënshkrime në secilën faqe të deklaratës nuk sanksionohet nga KPPK-ja. Kështu që vërtetimi siç u nënvizua më parë është i mjaftueshëm për qëllime të pranueshmërisë.

IV. PAPRANUESHMËRIA E PRETENDUAR E 'DITARËVE TË LUFTËS' TË A. Z.

69. Gjykata e Qarkut ka vlerësuar gjithashtu që 'Ditarët e luftës' të A. Z. si prova të papranueshme për shkak të faktit që ato nuk i janë zbuluar mbrojtjes parat marrjeve në pyetje në mes të 5 dhe 9 korrikut 2012 prandaj edhe janë përjashtuar që të jenë subjekt i "marrjes përsëri në pyetje" të A. Z. në pajtim me nenin 156 paragrafin 2 të KPPK-së.

70. Gjykata Supreme gjen se ditarët e A. Z. pa ndonjë përjashtim janë prova të pranueshme.

Çështja siç është ngritur nga Gjykata e Qarkut në plan të parë e merr rëndësinë e saj sipas aspektit që nëpërmes marrjes së pyetje të A. Z. ai në mënyrë të përsëritshme i referohet ditarëve të tij, posaçërisht të ashtuquajturve 'ditarët e luftës' dhe 'ditarët e pas luftës', të cilat ai i ofroi policisë së EULEX-it. Vlen të përmendet që nuk është ditur për ditarin gjerman deri pas vdekjes së tij. Ai megjithatë përshkruan në pika të ndryshme në deklaratat e tij se si këto ditarë janë mbajtur dhe mirëmbajtur. Pyetja shtrohet, nëse pranueshmëria e ditarëve varet apo jo nga ato që i janë siguruar mbrojtjes në përgatitjen e marrjeve në pyetje në korrik të vitit 2011.

Gjykata Supreme gjen se ditarët e A. Z. që nuk i janë siguruar në tërësi mbrojtjes nuk mundet aspak të dëmtojë pranueshmërinë e tyre si prova. Ditarët janë prova dokumentuese, që për këtë arsye pranueshmëria e tyre nënvizon kërkesa të

ndryshme prej atyre të deklaratave të dëshmitarit. Nuk ekzistojnë tregues që ato janë marr në mënyrë të jashtëligjshme. Gjykata Supreme gjen se ato nuk i janë zbuluar në tërësi mbrojtjes para seancave dëgjimore në mes të 5 dhe 9 korrikut 2011, pavarësisht se nuk ekziston obligim që prokurori të bëjë këtë, nuk mund të shpie në papranueshmërinë e tyre për shkak të faktit që dëshmitari nuk është "marr përsëri në pyetje" lidhur me përmbajtjet e tyre.

71. Pyetje tjetër që gjithashtu është drejtuar nga Gjykata e Qarkut është nëse ditaret janë prova të papranueshme, sepse ato nuk janë vërtetuar nga eksperti i grafologjisë, edhe pse avokatët mbrojtës kanë kërkuar ekspertizë të tillë në letrën dërguar prokurorit më 15 korrik 2011 në pajtim me nenin 239 të KPPK-së.

72. Gjykata e Qarkut mund të jetë nxitur nga shqetësimet e mbrojtjes, që atje do të jenë shumë karakteristika të ditareve që ngritin pyetje serioze lidhur me vërtetësinë e tyre. Përkundër dështimit të prokurorit që ndonjëherë të ofroj përgjigje, me anë të kësaj është vërtetuar që në pajtim me nenin 322 të KPPK-së, palët ose avokatët e tyre dhe kështu mbrojtja në lëndën në fjalë mund të kërkojnë që kryetari i kolegjit të aprovoj mbledhjen e provave të reja, duke përfshirë ekspertizën mjeko-ligjore, bile pas caktimit të shqyrtimit gjyqësor. Kjo gjithashtu zbatohet në ekspertizën e shkrimit të dorës. Sidoqoftë, vërtetësia e ditareve përsëri është pyetje që i takon vlerësimit të besueshmërisë së provës dhe jo pranueshmërisë siç është nënvizuar më parë në këtë aktgjykim.

C. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

73. Prokurori i PSRK-së e ka kundërshtuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të datës 2 maj 2012 për shkak të shkeljes së pretenduar të neneve 405 dhe 403 paragrafit 2, pikës 1 të KPPK-së. Në veçanti, trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut ka shkuar shumë përtej kompetencave të veta kur ka vendosur që edhe nëse deklaratat e A. Z. dhe të 'Ditarëve të luftës' së tij të shpallëshin si prova të pranueshme, megjithatë të pandehurit duhen të lirohen, pasi që nuk do të ketë në dispozicion prova të mjaftueshme vërtetuese. Kjo do të mund të përbëjë shkelje të nenit 405 të KPPK-së. Për më tepër, gjykata ka gabuar duke vlerësuar që konfiskimi i gjërave në lokalet e F. L. të cilat nuk kanë qenë të mbuluar me urdhrin për kontrollim, do të shpinte në papranueshmërinë e tyre si prova. E fundit por jo më pak rëndësishme, prokurori ka theksuar që Gjykata e Qarkut e ka keqinterpretuar aktakuzën, kur ka supozuar që të pandehurit në fjalë kanë qenë të akuzuar që kanë vepruar me përgjegjësi komanduese.

I. VLERËSIMI I PROVAVE I GJYKATËS SË QARKUT PËRTEJ ÇËSHTJES SË PRANUESHMËRISË SË DEKLARATAVE TË A. Z.:

74. Prokurori i PSRK-së në ankesën e tij e ka kundërshtuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të datës 2 maj 2012 për shkak të faktit se arsyetimi përcakton: 'që edhe nëse prova e A. Z. është ishte në shkresë [...] rezultati i këtij aktgjykimi do të mbetet i njëjtë', pasi që provat e dhëna nga A. Z. nuk do të vërtetoheshin nga provat

tjera lidhur me identifikimin e kryerësve të veprës. Në këtë mënyrë gjykata dukshëm do të tejkalonte kompetencat e veta dhe kështu ka shkelur nenin 405 të KPPK-së.

75. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se me të vërtetë se aktgjykimi i kundërshtuar shkel nenin 405 të KPPK-së.

76. Gjykata Supreme në tërësi pajtohet me shqetësimin e ngritur nga prokurori i PSRK-së. Nuk është në kompetencë të Gjykatës së Qarkut të vlerësojë, se çfarë do të jenë gjetjet e gjykatës tjetër do të jenë, pasi që prova që më parë është përjashtuar si e papranueshme tani konsiderohet si e pranueshme.

Ky arsyetim tregon që Gjykata e Qarkut nuk ka qenë aspak e sigurt lidhur me gjetjet veta që kanë të bëjnë me pranueshmërinë e provave dhe ka tentuar që ta mbështes me parashikimin e rezultatit të vendimit nëse prova në pyetje të kishte qenë e pranueshme.

77. Neni 287 paragrafi 2 i KPPK-së bën prezantimin komplet dhe vlerësimin e plotë të provave të paraqitur në lidhje me njëra tjetrën para përfundimit nëse fakti i veçantë është vërtetuar si parakusht i nevojshëm për secilin aktgjykim. Gjykatës nuk i lejohen parashikime hipotetike për rezultat para përfundimit të procedurës së lart përmendur. Në njërën anë duke shpallur sasi të madhe të provave si të papranueshme dhe në të njëjtën kohë duke parashikuar që dhe po qe se do të pranohej rezultati përsëri do të ishte i njëjtë, gjykata jo vetëm që e shkel nenin 405 të KPPK-së por edhe tregon për mendimin e formuar më parë që vazhdimi i procedurës së provave do të jetë paprëseprapë i pavlerë. Qëndrimi i tillë e vënë në dyshim serioz pavarësinë e kolegjit.

78. Sado që Gjykata e Qarkut të jetë e mendimit që duhet të ekzistoj vërtetim të së paku identitetit të kryerësve të veprës, Gjykata Supreme gjen se interpretim i këtillë të kërkesave për vërtetim nuk përkrahet nga ligji.

Neni 157 paragrafi 4 i KPPK-së vetëm përcakton që gjykata 'nuk e shpall personin fajtor vetëm mbi bazën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues'. Kështu, ligji nuk kërkon vërtetim të plotë të provës sa i përket të gjitha fakteve relevante ose deri në nivel vendimtar. Vetëm një lloj vërtetimi është i nevojshëm që të sigurohet që akuzat e ngritur nga dëshmitari bashkëpunues janë pasqyruar gjithashtu nga burimet tjera. Niveli i vërtetimit të nevojshëm do të duhej të siguronte që dëshmitari bashkëpunues mos të deklaroj asgjë të keqe në dëm të tjerëve, vetëm duke qenë i udhëhequr nga interesi personal.

79. Edhe pse aktgjykimi në pjesën e diskutuar bazohet në supozime hipotetike të papranueshme, ai vë në pah gabimin e ngatërrimit të çështjes së pranueshmërisë dhe besueshmërisë së provave, siç është theksuar më lart në këtë aktvendim.

Çështja nëse provat e dhëna nga A. Z. janë vërtetuar në mënyrë të mjaftueshme nuk është e lidhur me aspektin e pranueshmërisë por bie në fushën e besueshmërisë së provave të dëshmitarit dhe prandaj ato mund të vlerësohen vetëm në fund të procedurës së provave në bazë të vlerësimit të të gjitha provave të paraqitura nga palët, një nga një si dhe në lidhje me të gjitha provat e tjera të pranueshme. Për më tepër, një vlerësim i tillë duhet të bëhet me kujdesin më të madh të mundshëm dhe të

marrë parasysh të gjitha aspektet relevante dhe detajet e provave të pranuar, por nuk mund të bëhet vetëm në mënyrë përmbledhëse në fund të arsyetimit të një aktgjykimi.

II. PAPRANUESHMËRIA E PRETENDUAR E PROVAVE PËR SHKAK TË URDHËRIT TË PAMJAFTUESHËM PËR BASTISJE:

80. Prokurori i PSRK-së ka kundërshtuar se në aktgjykimin e shkallës së parë të datës 02 maj 2012, Gjykata e Qarkut ka trajtuar provat e konfiskuara në shtëpitë e F. [redacted] L. [redacted] dhe N. [redacted] KR. [redacted] si të papranueshme për shkak të faktit se gjoja nuk ka pasur urdhër të veçantë të lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake për bastisjen e të dy shtëpive.

81. Gjykata Supreme nuk gjen asnjë shkelje të nenit 244 të KPPK-së nga ana e Prokurorit të PSRK-së në lidhje me bastisjen e referuar dhe prandaj papranueshmëria e materialeve të konfiskuara nuk mund të vërtetohet në lëndën në fjalë.

Ajo për çka është brengosur Gjykata e Qarkut ka qenë fakti se asnjë urdhër i veçantë për bastisje nuk është propozuar nga PSRK-ja dhe lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake në lëndën nën hetime GJPP 25/10 (PPS 07/10), por që materialet janë gjetur dhe konfiskuar si rezultat i bastisjes së kryer me urdhrin për bastisje në lëndën nën hetime GJPP 91/10 (PPS 425/09), krimet e të cilit nuk ka qenë të lidhura me aktakuzën në lëndën në fjalë. Gjykata e Qarkut shprehimisht ka theksuar në aktgjykimin e saj të kundërshtuar se as aktvendimi në lëndën GJPP 91/10 (PPS 425/09) e as 'aktvendimi mbi zgjerimin e hetimeve kundër F. [redacted] L. [redacted] [...] ka dhënë indikacione se hetimet janë zgjeruar për të përfshirë F. [redacted] L. [redacted] si rezultat i artikujve të konfiskuar në bastisjen e 28 prillit 2010. Në mënyrë që të aplikohet neni 244 i KPPK-së, objektet duhet të jenë të tilla që të drejtojnë në një vepër tjetër penale dhe të përbëjnë bazë për fillimin e hetimeve. Prokurori nuk ka sqaruar nëse ka qenë ashtu (f.37 nr.55 e aktgjykimin të kundërshtuar në versionin në gjuhën angleze). Prandaj, provat e marra gjatë kësaj bastisje do të ishin të papranueshme për shkak të nenit 246 paragrafit 1 pikës 1 të KPPK-së.

82. Gjykata Supreme gjen se vlerësimi i Gjykatës së Qarkut është i gabuar, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 244 të KPPK-së si dhe faktin se sipas nenit 245 të KPPK-së bastisja në rrethana të caktuara është e mundur madje edhe pa urdhër për bastisje.

Neni 244 i KPPK-së si nen relevant në lëndën në fjalë përcakton si në vijim:

Nëse gjatë kontrollit të personit, shtëpisë ose lokaleve gjenden sende të cilat nuk kanë të bëjnë me veprën penale për të cilën është zbatuar kontrolli, por që tregojnë një vepër tjetër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, këto sende gjithashtu përshkruhen në procesverbal, konfiskohen [...]. Prokurorit publik menjëherë i dërgohet njoftimi për fillimin e procedurës [...].

83. Gjykata e Qarkut ka keqinterpretuar nenin 244 të KPPK-së se gjyqtarët kinse kanë kuptuar se provat shitesë të marra duhet të drejtojnë në një vepër penale krejtësisht të re, e cila ka qenë e panjohur deri në momentin e marrjes së provave. Një interpretim i tillë tepër formal i dispozitës do të shpinte në absurditetin se provat e marra rastësisht dhe në një rast të bastisjes në një lëndë tjetër nuk do të mund të përdoren vetëm për

shkak se provat që i takojnë lëndës nuk është e re, por hetimet tanimë kanë filluar. Kjo nuk mund të jetë ajo që kërkon ligji, duke pasur parasysh *ratio legis* të nenit 244 të KPPK-së, që është e kundërta e asaj që ka kuptuar Gjykata e Qarkut, përkatësisht për të siguruar se provat e marra shtesë do të jenë të qasshme në lëndën të cilës i përkasin.

84. Në lëndën në fjalë, hetimet penale teknikisht kanë filluar dhe zgjeruar me aktvendimin në shkurt 2010 dhe përsëri janë zgjeruar kundër të pandehurve të tjerë në qershor 2010. Prandaj, asnjë aktvendim 'tjetër' mbi fillimin e hetimeve nuk ka qenë i nevojshëm më.

85. Sa i përket dështimit të Prokurorit për të sqaruar ku saktësisht janë gjetur provat (edhe pse është e qartë nga shkresat e lëndës se p.sh. raportet mjekësore të A [redacted] Z [redacted] janë gjetur në dhomën e fjetjes së F [redacted] L [redacted]), Gjykata e rigjykimit është ftuar që të dëgjoj Prokurorin si dëshmitar.

D. Trupi gjykues tjetër në rigjykim:

68. Në lidhje me propozimin e Prokurorit të PSRK-së për ta "dërguar lëndën në rigjykim para një trupi gjykues tjetër", Gjykata Supreme së pari gjen se neni 40 paragrafët 1 dhe 2 të KPPK-së mbi arsyet për përjashtimin e një gjyqtari nuk përcakton shprehimisht që lënda të dërgohet në rigjykim tek një trup gjykues i ndryshëm nga ai që është marrë me lëndën në raundin e parë të seancave në shkallën e parë. Dispozita e vetme e ligjit e cila bën referencë eksplicite arsyeve të përjashtimit për shkak të angazhimit të mëparshëm në lëndë në shkallën e njëjtë, neni 40 paragrafi 2 pika 4 e KPPK-së, ka parasysh angazhimin paraprak si prokuror, avokat mbrojtës, përfaqësues ligjor apo përfaqësues i autorizuar i palës së dëmtuar apo prokurorit, mirëpo nuk e përmend pozitën e gjyqtarit.

87. Sipas nenit 6 paragrafit 1 të KEDNj-së duke i bërë referencë '[...] gjykatës së themeluar me ligj' dhe sipas udhëzimit mbi caktimin e lëndëve të miratuar për secilën gjykatë në Kosovë⁸, caktimi i lëndëve tek gjyqtarët individual si kryetar të kolegjit dhe gjyqtar raportues duhet të bëhet sipas orarit sistemit të parapërcaktuar në bazë të kriterëve objektive dhe në mënyrë transparente dhe ri-përsëritshme. Mungesa e një autorizimi eksplicit i një gjykate më të lartë për ta kthyer lëndën në rigjykim para një trupi gjykues të ndryshëm në mënyrë sistematike ka pasur për qëllim ligji mbi procedurën penale. Do të ishte në kundërshtim me këto parime nëse gjykata më e lartë do të ndërhynte në mënyrë të drejtpërdrejtë në caktimin e lëndëve tek gjyqtarët individualë.

88. Dispozitat e ligjit për përjashtimin e gjyqtarëve janë të mjaftueshme për të siguruar paanshmërinë e gjykatës. Sidoqoftë, ato duhet të vërehen nga vetë gjyqtarët e caktuar në lëndë ose përmes kërkesës së palëve në procedurë, sipas neneve 42 ff. Të KPPK-së. Prandaj, autorizimi nga gjykata më e lartë që të urdhërojë rigjykim pranë një trupi gjykues të ndryshëm apo përjashtimin e një anëtari të trupit gjykues as nuk është kusht e as nuk është qëllimi i ligjit.

⁸ Shih Udhëzimin mbi caktimin e lëndëve për gjyqtarët e EULEX-it në lëndë penale në Gjykatën Supreme të Kosovës të miratuar në Asambllënë e 14-të të Gjyqtarëve të EULEX-it më 24 mars 2011.



Në lidhje me kushtin për paanshmërinë e gjykatës, GjEDNj si parim ka përcaktuar se:

*'...nuk mund të thuhet se si rregull i përgjithshëm i cili rezulton nga një obligim për të qenë i paanshëm se gjykata më e lartë e cila lë anash një vendim administrativ apo gjyqësor detyrohet që ta dërgojë lëndën tek një autoritet tjetër i juridiksionit apo tek një trup gjykues i përbërë ndryshe i atij autoriteti.'*⁹

Në lidhje me standardet për të vlerësuar nëse në trupo gjykues është i paanshëm, GjEDNj ka shtjelluar:

'Gjykata përsërit se paanshmëria në kuptim të nenit 6 § 1 të Konventës, normalisht paraqet mungesën e paragjykimin apo anshmërisë. Eksitojnë dy teste për të vlerësuar nëse gjykata është e paanshme: i pari përbëhet nga kërkimi për të përcaktuar bindjen personale të gjyqtarit apo interesin në lëndën e dhënë dhe e dyta në vërtetimin nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çfarëdo dyshimi legjitim në lidhje me këtë ... Gjatë aplikimit të testit të parë, paanshmëria personale e gjyqtarit patjetër duhet të supozohet derisa të dëshmohet e kundërta. ...

*Në lidhje me testin e dytë, kur aplikohet ndaj një organi që vepron si trup gjykues, do të thotë të përcaktohet nëse, ndaras nga sjellja personale e cilitdo anëtar i atij organi, eksitojnë fakte të vërtetueshme të cilat mund të ngritin dyshime sa i përket paanshmërisë së tij. Në lidhje me këtë, madje edhe paraqitjet mund të jenë të një rëndësie. Kur është duke u vendosur nëse në lëndën e dhënë ekzistojnë arsye legjitime për t'u frikuar se organit të caktuar i mungon paanshmëria, pikëpamja e atyre që pohojnë se nuk është i paanshëm është e rëndësishme mirëpo jo vendimtare. Ajo që është vendimtare është nëse frika mund të arsyetohet në mënyrë objektive.'*¹⁰

89. Në lëndën në fjalë, Gjykata Supreme i referohet klauzolës së përgjithshme të përcaktuar me nenin 40 paragrafin 3 të KPPK-së, sipas të cilës *Gjyqtari [...] gjithashtu mund të përjashtohet nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në rast konkret, përpos rasteve nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni kur prezantohen dhe vërtetohen rrethana që e vënë në dyshim paanshmërinë e tij.* Kjo dispozitë e procedurës penale vendore duhet të interpretohet në përputhje me jurisprudencën e lartpërmendur të GjEDNj-së.

90. Siç është shtjelluar më parë, Gjykata e Qarkut në aktgjykimin e kundërshtuar në mënyrë të qartë ka tejkalluar kompetencat e saj duke vlerësuar se për shkak të mungesës së pretenduar të provave vërtetuese në lidhje me identitetin e kryerësve *'rezultati i këtij aktgjykimi do të mbetet i njëjtë [...] [edhe] nëse provat e A Z do të ishin në dosje.* Në bazë të kësaj deklarate ekziston një shqetësim i arsyetuar objektiv se vlerësimi i drejtë dhe i lirë i provave përfshirë edhe provat e reja tani të pranueshme do të ishte përfundim i ditur dhe i pamundur nga trupi gjykues në përbërje të njëjtë.

⁹ Ringeisen kundër Austrisë, kërkesa nr. 2614/65, 16 korrik 1971, paragrafi 97

¹⁰ Lindón et al. kundër Francës, kërkesa nr. 21279/02 dhe 36448/02, 22 tetor 2007, paragrafi. 75 ff.

Për shkak të kësaj, janë vërtetuar dyshime serioze në lidhje me paanshmërinë e gjyqtarëve të shqyrtimit gjyqësor të mëparshëm dhe lënda nuk do të gjykohej përsëri nga të njëjtit gjyqtarë.

91. Prandaj, Gjykata Supreme përfundon se lënda duhet të rigjykohej nga një tjetër trup gjykues.

Në bazë të arsyeve të lartpërmendura Gjykata Supreme ka vendosur si në dispozitiv.

E. Përmbledhje

92. Të gjitha provat e përmendura në dispozitiv janë të pranueshme në rigjykim. Dyshimet në lidhje me vlerën e provave individuale duhet të merren parasysh në fazën e vlerësimit përfundimtar të besueshmërisë në pajtim me nenin 387 paragrafin 2 të KPPK-së.

93. Gjykata Supreme përfundon se në bazë të deklaratave në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, ekziston një shqetësim i arsyetuar objektiv se vlerësimi i drejtë dhe i lirë i provave përfshirë edhe provat e reja tani të pranueshme do të ishte përfundim i ditur dhe i pamundur nga trupi gjykues në përbërje të njëjtë. Si rrjedhojë, janë vërtetuar dyshime serioze në lidhje me paanshmërinë e gjyqtarëve në shqyrtimin gjyqësor të mëparshëm dhe rigjykimi duhet të mbahet nga një trup gjykues në përbërje tjetër.

94. Provat e sekuestruara gjatë bastisjes së hapësirave të N. KR. dhe F. L. janë të pranueshme në procedurën penale aktuale në bazë të dispozitave të neneve 244 dhe 245 të KPPK-së.

Kryetar i kolegjit:

Gerrit-Marc Sprenger
Gjyqtar i EULEX-it

